



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Nr. 814/14 Prot.

Tiranë, më 31.12.2016

V E N D I M
Nr. 179, Datë 31.12.2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
ALBPETROL SHA MBI “ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE
RREGULLSHMËRISË SË VEPRIMTARISË EKONOMIKO -
FINANCIARE”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” të ushtruar në Albpetrol SHA, për periudhën, nga data 01.07.2015 deri me datë 30.09.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

A.I - Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës, vendimet e marra prej tij dhe zbatimi i tyre.

1. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të veprimtarisë së Këshillit mbikëqyrës dhe observacioneve rezultoi se:

- Në kundërshtim me nenin 25 të statutit të shoqërisë Albpetrol SHA, këshilli mbikëqyrës nuk ka mbajtur në libra të posaçëm të procesverbaleve të të gjithë takimeve dhe të gjitha mbledhjeve të këshillit mbikëqyrës, përfshirë dhe emrat e administratorëve të pranishëm.

- Nuk vërtetohet se Kryetari i këshillit mbikëqyrës ka thirrur mbledhjet, sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 318, datë 8.4.2009, kreu II/6. a, si dhe nuk ka përcaktuar vendin e zhvillimit të mbledhjes (III/2);

- Këshilli mbikëqyrës nuk ka hartuar dhe miratuar programin vjetor për aktivitetin e drejtorisë dhe të mbledhjeve të tjera të posaçme të kërkuara nga vetë këshilli apo drejtoria, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009, kreu III/1;

- Këshilli mbikëqyrës nuk ka miratuar programin vjetor të auditimit për vitin 2016 dhe nuk ka kontrolluar zbatimin e tij çdo tremujor, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009, kreu IV/6;

- Në vendimin nr. 3, datë 30.09.2013 për emërimin e Administratorit të shoqërisë Albpetrol SHA, këshilli mbikëqyrës nuk ka përcaktuar pagën e tij, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009, kreu IV/2;

- Nuk ka miratuar nivelin e pagave të punonjësve të Albpetrol SHA, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive financiare të shoqërisë, në kundërshtim ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", neni 6, pika 1, shkronja "a" (trajtuar më hollësisht në faqet 43-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës gjatë veprimtarisë së tij të shmangë problematikat e evidentuara më sipër, si dhe të zhvillojë aktivitetin e tij të dokumentuar sipas kërkesave të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar; VKM nr. 642, datë 11.10.2005, "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore" i ndryshuar; Udhëzimit të ministrit të METE nr. 318, datë 8.4.2009 "Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore"; si dhe të Statutit të shoqërisë Albpetrol SHA.

Vazhdimisht

- **Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore, si dhe zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.**

2. Gjetje nga auditimi:

Në kontratën individuale të punës: nuk ka referencë rregulloren e brendshme për përshkrimin e vendit të punës; nuk është përcaktuar procedura e shqyrtimit të masës disiplinore pas datës 05.06.2016; është vendosur shpërblimi prej 10 mijë lekë në kohën e marrjes së pushimeve vjetore, pa marrë parasysh gjendjen financiare të shoqërisë; është vendosur shtesë për titullin shkencor (master profesional dhe/ose shkencor), pa qenë në përshkrimin e punës së nëpunësit dhe as në kërkesat e pozicioneve të punës të Rregullores së brendshme të Albpetrol SHA dhe si e tillë është e paligjshme.

Pagat e punës të përcaktuara nga Administratori me vendimin nr. 266, datë 25.04.2014, për miratimin e tabelave të reja të pagave të shoqërisë Albpetrol SHA, pa marrë miratimin nga

Këshilli mbikëqyrës dhe nga ministri përkatës (MZHETTS), janë në kundërshtim me ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1/a: “1. Organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 % shtetëror, miratojnë: a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës.

Në periudhën nga data 01.07.2015 deri me 30.09.2016 janë paguar 79 punonjës për vendime gjyqësore të largimeve nga puna pa shkaqe të arsyeshme të periudhave të mëparshme në shumën 58,448,661 lekë, si dhe zbatimi nëpërmjet Zyrave përmbarimore i këtyre vendimeve të gjykatave në 40 raste për vitin 2016, është kosto shtesë në shpenzimet e përgjithshme të Albpetrol SHA (trajtuar më hollësisht në faqet 43-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)..

Për këtë rekomandojmë:

2.1. Albpetrol ShA të marrë masat e nevojshme për të rihartuar kontratën e punës, duke shmangur problematikën e evidentuar deri tani në lidhje me përshkrimin e përgjithshëm të punës, procedurat e shqyrtimit të masës disiplinore, për shpërblimin 10 mijë lekë në kohën e marrjes së pushimeve, për heqjen e shtesave të pagës për titullin shkencor etj., duke siguruar një transparencë më të madhe kundrejt punëmarrësve, si dhe duke e bërë atë në përputhje të plotë me Kodin e Punës.

Brenda tremujorit të parë 2017

2.2. Albpetrol ShA të marrë masat e nevojshme për të miratuar nivelin e pagave sipas pozicioneve të punës për administratën dhe qendrat sipas procedurës dhe kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

Brenda muajit janar 2017

2.3. Albpetrol ShA të shmangë largimet e paligjshme nga puna të punonjësve duke respektuar kërkesat e kontratës individuale të punës, kontratën kolektive dhe përcaktimet e Kodit të Punës të cilat kanë rënduar shpenzimet për periudhën e audituar në shumën 58,448,661 lekë, si dhe të nxirren përgjegjësitë individuale për mosrespektimin e kërkesave të Kodit të Punës.

Brenda tremujorit të parë 2017

3. Gjetje nga auditimi:

Albpetrol SHA nuk ka zbatuar shkronjën “b” të nenit 1 të ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë” dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë” derdhur në Institutin e Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë për të arkëtuar për llogari të Institutit të Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë shumën 1 % të fondit të pagave për vitin 2015 (trajtuar më hollësisht në faqet 47-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol ShA të zbatojë ligjin nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë”, për të derdhur 1 % të fondit të pagave për vitin 2015 dhe 2016 në Institutin e Integritit të ish-të Përndjekurve Politik.

Brenda muajit janar 2017

- Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomiko-financiar. Ndjekja dhe realizimi i treguesve ekonomiko-financiarë në qendër dhe filiale.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se në Albpetrol SHA, programi ekonomiko-financiar për vitin 2015, paraqitet me një mosrealizim në vlerën neto 186 milion lekë. Albpetrol SHA me gjithë ndryshimet në ulje për të ardhurat, të aprovuara në ministrinë përkatëse nuk mundi të realizonte treguesit ekonomiko financiar. Mos realizimi i investimeve për vitin 2015 ka ndikuar negativisht në rritjen e të ardhurave të shoqërisë. Ky problem duhej të ishte analizuar me hollësi, duke përcaktuar rrethanat dhe përgjegjësitë (trajtuar më hollësisht në faqet 53-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria e Programimit, të marrin masa për hartimin e programit ekonomiko-financiar me tregues të harmonizuar dhe të bashkërenduar, duke ndjekur të gjitha fazat përkatëse, si dhe periodikisht të analizojë ecurinë e tyre, duke përcaktuar masa konkrete për përmirësimin e gjendjes dhe realizimin e tyre. Të merren masa për programimin dhe realizimin e investimeve duke përcaktuar saktë prioritetet për ndërhyrje, me synim arritjen e përfitimeve nëpërmjet tyre dhe rritjen e të ardhurave të Shoqërisë.

Vazhdimisht

-Mbi organizimi dhe mbajtjen e evidencave kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi e miratimi i tij në organet e vartësisë.

5. Gjetje nga auditimi: Shoqëritë koncesionare shoqërojnë me fatura tatimore shitje sasi të naftës që i detyrohen Albpetrol SHA, për zbatimin e marrëveshjeve hidrokarbure. Këto blerje janë të regjistruara në llogaritë e brendshme ndërmjet qendrave të kompanisë. Shoqëria për të eliminuar efektin që krijojnë këto blerje jo reale, u lëshon fatura shitje me të njëjtën vlerë. Në pasqyrat financiare shitjet e kryera ndaj kompanive koncesionare për efekt kompensimi, janë grupuar në një llogari me shitjet reale të shoqërisë duke e deformuar llogarinë e të ardhurave. (trajtuar më hollësisht në faqet 57-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria Ekonomike shitjet dhe blerjet me fatura tatimore që bëhen për efekt të marrjes së naftës nga kompanitë koncesionare, të evidentohen të ndara, me shpjegimet përkatëse në mënyrë që të mos deformohet rezultati ekonomiko-financiar.

Vazhdimisht

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i rregullshmërisë dhe saktësisë të shpenzimeve të amortizimit u konstatua se janë përdorur norma të amortizimit të miratuara me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 24, datë 30.04.2007, të cilat janë të ndryshme nga normat amortizimit të përcaktuara në ligjet në fuqi, për efekte tatimore dhe njëkohësisht janë norma që nuk i përshtaten normave menaxheriale të amortizimit të pajisjeve (trajtuar më hollësisht në faqet 57-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria ekonomike e Albpetrol SHA në bashkëpunim me specialistët e fushës të kryej një analizë të hollësishme të kohëzgjatjes së aktiveve dhe të propozojë në këshillin mbikëqyrës për ndryshimin e normave të amortizimit, në reference të normave të amortizimit të miratuara me ligj për efekte tatimore, si dhe ato menaxheriale për zbatim në pasqyrat financiare, duke pasur në konsideratë dhe efektet që do të japë në pasqyrat financiare.

Vazhdimisht

7. Gjetje nga auditimi: Qendra e Administrimit dhe Shitjes së Naftës dhe Gazit Patos (QASHNG), përdor për regjistrimet kontabël të vitit 2015 dhe 2016, programin Microsoft Excel, program të cilin e disponon vetëm një operatore dhe vetëm një kompjuter. Programi

“Microsoft Excel” me të cilin operon QASHNG Patos, nuk të ndalon mundësinë e ndryshimit të veprimeve kontabël të periudhave të mëparshme, duke lënë të hapur mundësinë për ndryshime të këtyre veprimeve, në mënyrë abuzive ose të paqëllimshme, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 3, pika 9 (trajtuar më hollësisht në faqet 57-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria Ekonomike, të merren masa për përshtatjen e programit kompjuterik në Qendrën e Administrimit Shitjes Naftës dhe Gazit Patos, në përputhje me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 3, pika 9.

Brenda datës 31.03.2017

8. Gjetje nga auditimi: QASHNG ka paraqitur në pasqyrat financiare të viti 2015, në grupin e Aktiveve Afatshkurtra, llogarinë “Të tjera”, në vlerën **445,582,548 lekë**. Kjo vlerë përbëhet nga denoncime për vjedhje në vlerën 241,075,211 lekë, denoncim për firot e naftës në vlerën 112,629,300 lekë, tubacione të transferuara në vlerën 90,382,780 lekë dhe propozim për jashtë përdorimi në vlerën 1,495,257 lekë. Paraqitja e kësaj vlere nuk është në përputhje me Standardet e Kontabilitetit, për arsye se nuk ka një ndarje të qartë nëse janë zëra shpenzimesh dhe provizione për shpenzime ose të drejta të arkëtueshme, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 6 “Evidenca mbështetëse”, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 1 “Kudri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”, paragrafi 35 dhe Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 2 “Paraqitja e pasqyrave financiare”, paragrafët 17-22 “Dallimi mes zërave afatshkurtër dhe afatgjatë të aktiveve dhe pasiveve” (trajtuar më hollësisht në faqet 57-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga Administratori i shoqërisë, Drejtoria Ekonomike dhe QASHNG Patos, të merren masa për paraqitjen dhe kontabilizimin e saktë në pasqyrat financiare të vlerës 445,582,548 lekë, në zbatim të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, duke analizuar historikun e krijimit sipas zërave përkatës, si dhe duke evidentuar përgjegjësitë administrative.

Brenda datës 31.03.2017

9. Gjetje nga auditimi: QASHNG ka paraqitur në pasqyrat financiare të viti 2015, llogarinë “Provizione” në vlerën 38,833,280 lekë. Nga auditimi i kartelës së kësaj llogarie, u konstatua se kjo llogari gjatë viteve ushtrimore 2013-2015, nuk ka patur asnjë lëvizje kreditore ose debitore. Për më tepër nga ana e QASHNG Patos, për këtë llogari, nuk disponohej asnjë dokumentacion, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 6 “Evidenca mbështetëse” (trajtuar më hollësisht në faqet 57-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Nga Drejtoria e Ekonomike pranë Albpetrol SHA, Administratori dhe QASHNG Patos, të merren masa për paraqitjen dhe kontabilizimin e saktë të zërit “Provizione”, në vlerën **38,833,280 lekë**, në përputhje me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 6 “Evidenca mbështetëse”.*

Brenda datës 31.03.2017

- Mbi auditimin e gjendjes së debitorëve dhe kreditorëve, si dhe zbatimin e ligjshmërisë për inventarizimin e pasurisë.

10. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Albpetrol SHA nuk është bërë arkëtimi i detyrimit prej **3,445,021,679 lekë** të A SHA në zbatim të vendimit të gjykatës nr. 1480 datë 29.02.2016. Në detyrim e mësipërm janë të përfshira kamatat e arritura që rrjedhin nga mos shlyerja në kohë e kësteve të maturuara prej 20,269,908 lekë. Ky vendim është marrë me ekzekutim të përkohshëm, çka i jep mundësi shoqërisë për arkëtimin e detyrimit. Megjithëse uzina e përpunimit të thellë të naftës prone e A sha është vënë në punë (kjo e konfirmuar dhe nëpërmjet mediave), Albpetrol SHA nuk ka kryer asnjë veprim arkëtimin e detyrimeve të mësipërme (trajtuar më hollësisht në faqet 80-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga strukturat drejtuese të Albpetrol SHA të merren të gjitha masat përkatëse ligjore për arkëtimin e detyrimit që shoqëria A SHA ka ndaj shoqërisë si dhe të nënshkruhen marrëveshjet përkatëse me administratorët aktual të shoqërisë A SHA.

Brenda datës 31.03.2017

- Mbi zbatimin e ligjshmërisë në veprimet e arkës dhe bankës në lekë e valutë, si dhe blerjet me vlera të vogla.

11. Gjetje nga auditimi:

- Gjatë auditimit me zgjedhje të dietave të paguara u konstatuan parregullsi në procedurat e mbajtjes së tyre, plotësimit të urdhrave të shërbimit, mbajtjes së tyre.

- Me urdhrin e administratorit nr. 380/1 prot, datë 04.02.2014, janë bërë pagesa për biletat e transportit të punonjësve nga Tirana për në qendrat e punës, në kundërshtim me nenin 126, pika 1 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi këto shpenzime nuk janë për realizimin e punës. Nga auditimi rezulton se për vitin 2015 këto shpenzime përbëjnë rreth 18 % të shpenzimeve të likuiduara nga shoqëria për këtë qëllim, ndërsa janë ndërprerë pagesat të tilla pas kësaj periudhe me urdherin e administratorit nr. 123, datë 08.01.2016 (trajtuar më hollësisht në faqet 86-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA, të marrë masa që në të ardhmen pagesat e dietave të kryhen mbështetur në dokumentacionin e plotësuar me rregullsi dhe sipas procedurave të miratuara.

Pagesat e shpenzimeve të transportit të punonjësve të llogariten saktë e konform kërkesave të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 dhe urdhrin të ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr. 125, datë 26.12.2011.

Vazhdimisht

12. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2015 në Albpetrol SHA janë shpenzuar 6,296,379 lekë për sigurimin e automjeteve. Blerja e shërbimit është kryer pa u zbatuar procedurat ligjore të prokurimeve, nuk është nxjerrë urdhri i prokurimit, përcaktimi i fondit, ngritja e komisionit të vlerësimit si dhe njësia e prokurimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (trajtuar më hollësisht në faqet 86-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA, të marrë masa që në të ardhmen shërbimi i sigurimit të automjeteve të bëhet duke zbatuar procedurat ligjore të prokurimeve.

Vazhdimisht

13. Gjetje nga auditimi: Albpetrol SHA më 30.04.2015 ka lidhur kontratën e shërbimit për “Rivlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale, sipas standardeve ndërkombëtare të

kontabilitetit, SNK 16 dhe SNK36”, me grupin e ekspertëve të përbërë nga znj. S.T, znj. A.M, z. K.N, znj. A.Ç, znj. Y.S, z. D.V.

Rivlerësimi i asetëve dhe caktimi i ekspertëve është bërë me urdhërin e ish-ministrit të MZHETTS, z. A A në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë Albpetrol SHA, Patos. Vlera totale e kontratës është 100,000,000 lekë pa Tvsh.

Caktimi i ekspertëve është bërë në kundërshtim me ligjin e prokurimit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, pa kryer procedurat e prokurimit publik për kontratat e shërbimit.

Objekti i kontratës është përgatitja e raportit për Rivlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale të shoqërisë, sipas SNK 16, “Aktivet Afatgjata Materiale” dhe SNK 36, “Zhvlerësimi i Aktiveve”. Shërbimi që do të kryhet është për vlerësimin e tokave të shoqërisë duke verifikuar dokumentet e pronësisë, kontrollin fizik, kontabël, dhe vlerësimin e pronave të paluajtshme duke verifikuar dokumentet e pronësisë, kontrollin fizik, kontabël, verifikimin e vlerës fillestare dhe të mbetur; vlerësimi i aktiveve afatgjata materiale, objekte; përgatitja e pasqyrave të vlerësimit të aktiveve afatgjata materiale.

Nga verifikimi i zërave të objekteve në planifikimin e punës rezultoi se shuma e tyre është 46,014 objekte dhe jo 47,511 siç paraqitet në aneksin 2, me një diferencë prej 1497 objekte për një total 749 orë pune më tepër.

Me urdhrin nr. 2007 datë 20.02.2015, administratori ka caktuar grupin e punës të përbërë nga z. G.D znj. E.P dhe znj. V.J për shqyrtimin e bazës ligjore dhe negocimin e termave dhe kushteve kryesore të kontratës. Ky grup pune ka bërë 3 takime me grupin e ekspertëve duke arritur në totalin e orëve të punës sa më sipër.

Nga shqyrtimi i proces verbaleve të mbajtura u konstatua se nuk janë kërkuar oferta për punë të ngjashme nga ekspertë ligjorë ose studio ligjore të tretë por është negociuar me shembujt e sjellë nga grupi i ekspertëve, pa u bërë një vlerësim i tregut. Nuk mund të vlerësojmë efektet financiare, por këto veprime janë kryer në kundërshtim me parimin e ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike, si dhe neni 8 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, neni 8, Përgjegjshmëria menaxheriale”, pika 1 dhe 5 (trajtuar më hollësisht në faqet 86-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të marrë masa në të ardhmen të përdorë fondet publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet. Shoqëria të marrë masa për verifikimin e punës së ekspertëve në lidhje me verifikimin e dokumenteve të pronësisë, kontrollin fizik, kontabël, dhe vlerësimin e objekteve; vlerësimin e pronave të paluajtshme duke verifikuar dokumentet e pronësisë, kontrollin fizik, kontabël, verifikimin e vlerës fillestare dhe të mbetur, duke kërkuar materiale mbështetëse e dokumentuese në lidhje me proceset e kryera.

Vazhdimisht

- Mbi zbatimin e ligjshmërisë në fushën e prokurimeve, efektivitetin e investimeve, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

14. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Kontraktor (AK), në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, ka përcaktuar një fond limit të paargumentuar dhe të pa dokumentuar, për 5 procedura prokurimi. AK ka marrë për bazë oferta, të cilat nuk kanë si objekt të veprimtarisë fushën konkrete të prokurimit.

AK në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, ka përcaktuar në urdhrat e prokurimit, edhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, AK nuk ka argumentuar dhe dokumentuar vendosjen e kriterëve për kualifikim.

AK në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, nuk ka nënshkruar dokumentet e tenderit në çdo faqe.

AK ka tejkualuar afatin 5 ditor lidhur me procesin e vlerësimit të ofertave.

AK, në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP, ka kualifikuar shoqëri, të cilat nuk plotësojnë kriteret për kualifikim.

AK në kundërshtim të plotë me dispozitat e prokurimit publik, nuk duhej të kishte nënshkruar kontratën me shoqërinë e vetme të paraqitur në tender, si dhe nuk duhej të kishte bërë miratimin e raportit përmbledhës (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

AK të veprojë në përputhje të plotë me Ligjin për prokurimin publik. Në përlllogaritjen e fondit limit edhe kur merren ofertat në treg, duhet të dokumentohet i gjithë procesi në mënyrë transparente, duke mbajtur dokumentacionin përkatës.

AK në çdo rast, në hartimin e kriterëve për kualifikim, duhet t'i argumentojë dhe dokumentojë ato në një procesverbal, i cili duhet të mbahet nga personat përgjegjës të ngarkuar për përgatitjen e tyre si dhe dokumentet e tenderit duhet të nënshkruhen në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit që i kanë hartuar ato.

Në hartimin e kriterëve për kualifikim, njësia e prokurimit duhet të ketë në konsideratë dhe si objektiv, qëllimin e ligjit, pra nxitjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet tyre, si dhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Ato duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast, të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

Nisur nga shkeljet e konstatuara, AK duhet të bëjë trajnimin e stafit që merret me procedurat e prokurimit publik, të cilët duhet të kenë njohuri shumë të mira në zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik.

Vazhdimisht

A.II - Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e marrëveshjeve të hidrokarbureve të lidhura me kompanitë e huaja që operojnë në sektorin e kërkimit dhe nxjerrjes së hidrokarbureve.

Marrëveshja hidrokarbure për zonën Patos-Marinëz.

15. Gjetje nga auditimi: Bazuar në raportet e kontraktorit për të ardhurat e shpenzimet për periudhën nga fillimi i marrëveshjes deri në qershor 2016.

Deri në vitin 2013 janë miratuar planet vjetore, ndërsa për periudhën më pas nuk ka miratim. **Kontraktori ka paraqitur plane dhe zbatim të tyre pa marrë miratimin e Albpetrol dhe AKBN, të cilat kanë devijime të rëndësishme nga marrëveshja. Këto devijime kanë ndikim negativ të konsiderueshëm të faktorin R.** Pavarësisht se nuk ka miratim për to Albpetrol SHA nuk ka ndjekur hapat e mëtejshme që parashikon marrëveshja, si dhe nuk janë marrë masat përkatëse për konsiderimin thyerje marrëveshje dhe për kërkimin e riparimit të raporteve përkatëse në përputhje me planin e zhvillimit. Bazuar në raportet e kontraktorit, situata e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2013 deri qershor 2016, paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Janar 2013-qershor 2016 (mijë USD)		
	Program zhvillimi	Programe vjetore	fakti
Prodhimi i naftës brut	2,729,759.7	3,608,089.9	3,649,238.7
shpenzime	404,454	1,283,950	1,223,340

Sa më sipër rezulton se, sipas planit të zhvillimit është parashikuar të shpenzohen 404 milionë USD për arritjen e prodhimit në sasinë 2.72 milionë ton, ndërkohë që shpenzimi është realizuar me vlerë 1.28 miliardë USD, prodhimi i realizuar është 3.6 milionë ton. Pra janë parashikuar shpenzime në masën 14.8 % krahasuar me prodhimin e naftës brut, që në

fakt shpenzimet e realizuara janë në masën 33.5 % të prodhimit. Rritja e shpenzimeve nuk është justifikuar me rritjen e prodhimit. Rritja e shpenzimeve ka ndikim negativ në faktorin R, ndërsa rritja e prodhimit ndikon në rritjen e të ardhurave dhe rrjedhimisht përmirësim të faktorit R. **Në këto kushte, rezulton se nga ana e Kontraktorit bëhen përpjekje për mbajtjen e Faktorit R më të vogël se 1, duke shmangur vlerën e fitimit me Qeverinë Shqiptare.**

- Kontraktori nuk i është përmbajtur planit të zhvillimit të vitit 2006, rishikuar në vitin 2009.

- Duke krahasuar rritjen e shpenzimeve me rritjen e prodhimit të raportuara nga Kontraktori, pjesa takuese e rritjes së prodhimit me 919 mijë ton duhet të shoqërohej me rritje të shpenzimeve me vlerë rreth 136 milionë USD. Në këto kushte, bazuar në planin e zhvillimit, shpenzimet janë rritur në mënyrë të pa justifikuar me vlerë rreth 682 milionë USD.

- Mos respektimi i planit të zhvillimit dhe marrëveshjes në tërësi, ka cenuar interesat e Shtetit Shqiptar, për zonën me prodhimin më të madh në shkallë vendi dhe me burim naftë me cilësi të mirë.

- Plani i zhvillimit të vitit 2006 u rishikua në vitin 2009, në kundërshtim me interesat e shtetit shqiptar në këtë marrëveshje, megjithatë, kontraktori nuk ka zbatuar as këtë plan duke krijuar të ardhura të munguara për shtetin. Për më tej, në vitin 2016, nga ana e kontraktorit është kërkuar dhe ka marrë miratim ndryshimi i planit të zhvillimit, duke planifikuar Faktorin R më të madhe se 1, në fund të marrëveshjes, në kundërshtim të hapur me marrëveshjen hidrokarbure dhe planin e zhvillimit të paraqitur nga vetë kontraktori në vitin 2006 dhe të rishikuar në vitin 2009.

- Për periudhë e auditimit, kontraktori ka raportuar shpenzime me vlerë më të madhe se të ardhurat, duke bërë që Faktori R (sipas raporteve të kontraktorit), të jetë më i vogël se 1. Rritja e shpenzimeve dhe zvogëlimi i të ardhurave për vitin 2016, ka ardhur duke u thelluar, nga ku rezulton se shpenzimet e akumuluar krahasuar me të ardhurat janë më të mëdha se në vitin 2015, pra duke zvogëluar më tej Faktorin R.

- Përfshirja në kosto hidrokarbure e këtyre shpenzimeve ka ndikuar negativisht në Faktorin R, sipas të cilit nuk janë arritur përfitimet e parashikuara për Qeverinë Shqiptare. Vetëm si pasojë e mos respektimit të marrëveshjes dhe planit të zhvillimit sa më sipër, Qeveria Shqiptare rezulton me të ardhura të munguara me vlerë rreth 341 milionë USD (50 % e fitimit, sipas përcaktimeve në marrëveshje). Veprimi i mësipërm, i cili ka të bëjë me fryrje artificiale të shpenzimeve, veprim i cili është vërtetuar edhe nga auditimi i mëparshëm i ushtruar nga Albpetrol, për llogaritë kosto hidrokarbure të audituara për periudhën tetor 2012 deri shtator 2013, nga ku kanë rezultuar kosto hidrokarbure të pa pranuar me vlerë 352 milionë USD.

- Rritja e shpenzimeve, jo në përputhje me rritjen e prodhimit vërtetohet edhe me faktin e raportimit me diferencë të prodhimit me atë të prodhuar në fakt, rezultuar nga verifikimi i prodhimit të 147 puseve, nga të cilët 45 kanë rezultuar me prodhim më të madh nga ai i raportuar me afërsisht 283 m³ në ditë. Ky testim është realizuar nga vetë Albpetrol në 4 mujorin e parë të vitit 2015. Mos deklarimi i saktë i prodhimit të puseve përbën devijim material të marrëveshjes nga ana e Kontraktorit dhe përbën abuzim në raportimin e saktë të të ardhurave dhe rrjedhimisht mos përcaktimin real të Faktorit R, i cili duhet të ishte më i madh se i deklaruar dhe më i madh se 1. Albpetrol në bashkëpunim me AKBN duhet të merrnin masat përkatëse sipas përcaktimeve në marrëveshje për këtë qëllim.

- Nga ana e Albpetrol nuk janë audituar llogaritë kosto hidrokarbure pas shtatorit 2013, për të evidentuar mangësitë në raportimin e shpenzimeve të përfshira padrejtësisht në koston hidrokarbure, madje është rënë dakord për shtyrjen e periudhës së auditimit të tyre, duke vënë në rrezik reflektimin e kostove të tjera të cilat mund të jenë raportuar fiktivisht në kosto hidrokarbure, në raste të dështimit të kontraktorit në përmbushjen e marrëveshjes, apo ndërprerje të njëanshme të saj.

- Kjo pasuri po shfrytëzohet keq dhe në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure, pa marrë në konsideratë faktin se vetë marrëveshja është hartuar në mënyrë të disfavorshme për interesat e Shtetit.

- Krahas problematikës së mësipërme, kontraktori përpiqet të rrisë shpenzimet operative krahasuar me ato kapitale, të cilat shoqërohen me ulje të prodhimit pa ulur shpenzimet në tërësi, duke ndikuar negativisht Faktorin R.

- Peshën më të madhe në shpenzimet kapitale e përfshin hapja e puseve të rinj, hapja e të cilëve ka ardhur në rënie. Nga 163 puse të reja të hapura në vitin 2014, në vitin 2015 janë hapur 63 ndërsa në vitin 2016 asnjë. Zvogëlimi i numrit të puseve të reja të hapura nuk është shoqëruar me ulje të shpenzimeve respektive.

- Gjatë zbatimit të marrëveshjes, nga ana e Kontraktorit janë aplikuar teknologji dhe metoda të reja, me premtimin e uljes së shpenzimeve dhe rritjes së fitimit, por në fakt ka ndodhur e kundërta, shpenzimet rriten, prodhimi nuk rritet në raport me shpenzimet dhe të ardhurat gjithashtu nuk pësojnë rritje në raport me shpenzimet.

Nëse do të merreshin masat e duhura për monitorimin e inspektimin e vazhdueshëm, auditimin në përputhje me standardet dhe zbritjen e kostove të pa justifikuar nga operacionet hidrokarbure, Faktori R duhet të ishte më i madh se 1, vite më parë dhe do të ishte realizuar fitim për Qeverinë Shqiptare në vlera të konsiderueshme (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

15.1. *Albpetrol SHA në bashkëpunim me AKBN, bazuar në nenin 24, pika 24.2.1, të marrëveshjes hidrokarbure "Mbyllja" si dhe nenin 24, pika 24.1 të licencë marrëveshjes "E drejta e AKBN për t'a përfunduar marrëveshjen" të marrin masat e duhura për njoftimin e kontraktorit për devijime materiale dhe thyerje marrëveshje.*

15.2. *Nga ana e Albpetrol të auditohen llogaritë e kontraktorit duke filluar nga raporti i katërt i vitit 2014 e në vazhdim, duke zbritur kostot hidrokarbure të regjistruara në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure.*

15.3. *Albpetrol në bashkëpunim me AKBN, të analizojnë shkaqet dhe të kërkojnë nga Kontraktori zbatimin e planit të zhvillimit të vitit 2004, rishikuar në vitin 2009, duke reflektuar dhe zbritur nga kostot hidrokarbure shpenzime të pa arsyeshme, pa ekonomikitet, pa eficiencë dhe pa efektivitet, si dhe të regjistrojë në të ardhurat e kontraktorit sasinë e naftës brut të pa deklaruar, rezultuar nga testimi i puseve nga ku ka rezultuar një diferencë rreth 283 m³ në ditë. Veprimet e mësipërme kanë bërë që Faktori R të mbahet më i vogël se 1, duke shmangur fitimin për qeverinë Shqiptare në mënyrë fiktive.*

15.4. *Të analizohet rritja e shpenzimeve të paraqitura nga kontraktori duke filluar nga viti 2013, shpenzime të cilat janë rritur me arsyetimin e rritjes së prodhimit, rritje e cila është shumë e vogël në krahasime rritjen e prodhimit. Shpenzimet janë rritur 300 %, ndërkohë që prodhimi është rritur me vetëm me 30 %.*

15.5. *Të analizohen shpenzimet e realizuara për hapjen e puseve të reja të cilët nuk janë aktiv.*

Deri me 31.03.2017

15.6. *Të realizohen monitorime dhe inspektime të vazhdueshme të operacioneve hidrokarbure të kontraktorit, në mënyrë që t'i ndërpritet mundësia e abuzimeve me kostot hidrokarbure.*

Vazhdimisht

16. Gjetje nga auditimi: [REDAKTUAR], me shkresë nr. 352 prot., datë 23.03.2016, ka paraqitur programin e rishikuar për vitin 2016 duke rregulluar alokimin e zërave P&R ndërmjet shpenzimeve operative dhe kapitale në raport 70/30 (nga 50/50), bazuar në profilin e

buxhetit të shpenzimeve (paraqitur me 11 shkurt 2016). Ndryshimi i këtij raporti është në kundërshtim me planin e zhvillimit të vitit 2006, rishikuar në vitin 2009. Albpetrol SHA dhe AKBN, duhet të paraqisnin pretendimet në lidhje me këtë ndryshim, si dhe duhet t'i referohej për zgjidhje ekspertit, në përputhje me nenin 8, Pika 8.3 të marrëveshjes hidrokarbure, si dhe pikën 7. 2. iii, c të licencë marrëveshjes, Albpetrol SHA dhe AKBN duhet të çonin çështjen për përcaktim ekspertit, veprim i cili nuk është realizuar.

Janë raportuar shpenzime operative në vlerë 60,881 mijë USD dhe shpenzime kapitale në vlerë 17,598 mijë USD. Vlera e raportuar në shumën 43,283 mijë USD ose 5,492,612 mijë lekë, është në kundërshtim me planin e zhvillimit. Këto shpenzime duhet të ishin monitoruar dhe audituar nga Albpetrol dhe të mos pranohej rritja e tyre, sepse shpenzimet kapitale janë zvogëluar (numri i puseve aktiv është zvogëluar) dhe rrjedhimisht duhet të zvogëloheshin edhe shpenzimet operative. Rritja e shpenzimeve si më sipër, ka ndikuar më tej në mbajtjen e Faktorin R më të vogël se 1 (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA në bashkëpunim me AKBN, të marrin masat për njoftimin e Kontraktorit [REDAKTUAR] në kushtet e devijimit material në përputhje me nenin 8, Pika 8.3 të marrëveshjes hidrokarbure, si dhe pikën 7. 2. iii, c, të licencë marrëveshjes dhe t'i referojë ekspertit këtë devijim, duke kërkuar zbatimin me korrektësi të planit të zhvillimit të miratuar. Albpetrol SHA të marrë masa që gjatë procesit të auditimit të llogarive kosto hidrokarbure të kontraktorit, të analizojë dhe kërkojë reduktimin e kostove të përfshira padrejtësisht dhe në kundërshtim me planin e zhvillimit.

Brenda datës 31.01.2017

17. Gjetje nga auditimi: Deri në momentin e auditimit, nuk rezultojnë të jetë zgjidhur problematika e aseteve të përfshira nga Kontraktori [REDAKTUAR], si kolateral për marrjen e kredive. Albpetrol SHA me shkresë nr. 2258 prot., datë 27.02.2015, drejtuar [REDAKTUAR], për dijëni MEI dhe AKBN, ka kërkuar informacion në lidhje me asetet të cilat mund të jenë vendosur si kolateral për sigurimin e ndonjë kredie. [REDAKTUAR] me shkresë nr. 327/1 prot., datë 18.06.2015, ka kthyer përgjigje shkresës së mësipërme, nga ku theksohet se siç është në dijëni Albpetrol [REDAKTUAR] ka marrë kredi në tre banka ndërkombëtare [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], veprime të konsideruara nga kontraktori si në përputhje me marrëveshjen hidrokarbure.

AKBN me shkresë nr. 9827 prot., datë 17.11.2015, i është drejtuar bankave të nivelit të dytë me kërkesë për informacion mbi asetet e hipotekuara nga 5 kompanitë në marrëveshje hidrokarbure në fazë prodhimi.

Albpetrol me shkresë nr. 7944/3 prot., datë 20.04.2016, ka rikërkuar nga AKBN dokumentacionin e paraqitur nga [REDAKTUAR], për vendosjen e aseteve si kolateral, si dhe është kërkuar të vendoset në dispozicion çdo kopje e marrëveshjeve të kolateralit si dhe marrëveshjeve të kredisë që ka lidhur [REDAKTUAR] me [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe/ose [REDAKTUAR], të cilat duhet të jenë paraqitur pranë AKBN. Informacioni i kërkuar sa më sipër, është cilësuar nga Albpetrol si thelbësor në trajtimin e shkeljes materiale të njoftuar nga Albpetrol ndaj [REDAKTUAR], sipas njoftimit të përsëritur me shkresë nr. 2258/3 prot., datë 02.10.2015.

Kërkesa për dokumentacionin e mësipërm është ripërsëritur nga Albpetrol sipas shkresës nr. 7944/4 prot., datë 12.05.2016. MEI me shkresë nr. 2926/1 prot., datë 26.05.2016, nisur nga problematika e mësipërme, ka kërkuar bashkëpunimin ndërmjet Albpetrol dhe AKBN për zgjidhjen e këtyre problemeve.

AKBN me shkresë nr. 3470/2 prot., datë 05.08.2016, drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, MEI dhe Albpetrol, ka kërkuar opinion ligjor në lidhje me çështjen e aseteve në përdorim nga kompanitë që kryejnë operacione hidrokarbure në Shqipëri.

AKBN me shkresë nr. 4813 prot., datë 16.06.2016, drejtuar z. [REDAKTUAR], Drejtor i Përgjithshëm i [REDAKTUAR] dhe për dijeni MEI, ka ridërguar kërkesën për dërgim informacioni në lidhje me asetet duke theksuar se:

- Kërkesat e AKBN janë bazuar në nenin 17.2 të licencë-marrëveshjes.
- Kërkohe të bëhet menjëherë korigjimi i aseteve të rikuperuara në pasqyrat financiare të kontraktorit si dhe në raportimet e tjera.
- Në rast të mospërmbushjes së detyrimit të mësipërm kontraktual nga [REDAKTUAR], informohet se AKBN do të veprojë në përputhje me nenin 24.1 “E drejta e AKBN për t’a përfunduar” pika (a) “dorëzon me dijeni në AKBN deklarata fallco të cilat përbëjnë një konsideratë materiale për përfundim dhe/ose ekzekutimin e kësaj licencë-marrëveshje” (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA dhe AKBN të marrin masat përkatëse, duke vepruar sipas njoftimit të bërë me shkresë nr. 4813 prot., datë 16.06.2016, në përputhje me nenin 24.1 “E drejta e AKBN për t’a përfunduar” pika (a) “dorëzon me dijeni në AKBN deklarata fallco të cilat përbëjnë një konsideratë materiale për përfundim dhe/ose ekzekutimin e kësaj licencë-marrëveshje”, për detyrimin e kontraktorit për paraqitjen e dokumentacionit përkatës dhe reflektimin sipas marrëveshjes hidrokarbure dhe marrëveshje licencës, të vlerës së aseteve përdorur si kolateral për marrje kredie.

Brenda datës 31.01.2017

18. Gjetje nga auditimi: Për analizimin e situatës në zonën Patos-marinës, MEI ka nxjerrë Urdhrin nr. 89, datë 01.04.2015 “Për ngritjen e grupit të punës për analizimin e situatës në vendburimin e Patos-Marinëz”, pas incidentit të ndodhur gjatë shpimit të pusit nr. 5761.

AKBN me shkresë nr. 651 prot., datë 23.04.2015, ka dërguar informacion për MEI dhe Ministrinë e Mjedisit mbi monitorimin e cilësisë së ajrit në zonën Patos-Marinëz, realizuar nga AKBN. Nga monitorimi ka rezultuar se, në pikën 1 (100 m nga vendi i shpërthimit) vlera e SO₂ është 29.22 µ/m³, e cila është më e lartë krahasuar me normën e OBSH (që është 20 µ/m³). Po ashtu është monitoruar në pikën 2, ku vlera e SO₂ është në nivelin 33.6 µ/m³ duke tejkaluar normën e OBSH me 68 %. Mbi normat e lejuara ka rezultuara edhe NO₂, si dhe përmbajtja e PM₁₀, e cila kalon 4.5 herë normën e OBSH.

Procesi i konstatimit dhe vlerësimit të dëmeve është iniciuar dhe realizuar nga Ish-Komuna Kuman, Bashkia Roskovec, Këshilli i Qarkut Fier dhe Prefekti i Qarkut Fier, me pjesëmarrjen edhe të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

Nga vlerësimi ka rezultuar se, kanë pësuar dëme 118 subjekte, për të cilat është vlerësuar kompensim financiar me vlerë 305,309,451 lekë, kompensim i cili është ndarë në dy zona si më poshtë:

Zona A, ku shtëpitë e banimit dhe objektet e tjera funksionale janë vlerësuar si të pa banueshme, sipas Vendimit nr. 17, datë 05.08.2015 të Këshillit të Bashkisë Roskovec janë miratuar 43 subjekte përfitues me vlerë 284,861,368 lekë, nga të cilët për 6 subjekte është bërë rivlerësim. Me 41 subjekte janë nënshkruar marrëveshjet e dëmshpërblimit dhe u janë ekzekutuar shumat përkatëse, për 2 subjektet e mbetura [REDAKTUAR] është në pritje të veprimeve të Bashkisë Roskovec.

Për zonën B, ku shtëpitë e banimit dhe strukturat e tjera janë vlerësuar si pjesërisht të dëmtuara, sipas shkresës nr. 407 prot., datë 18.05.2015 të Komunës Kuman, janë miratuar 69 subjekte përfitues me vlerë 20,448,083 lekë, nga të cilat dy janë publikë (shkolla 9-vjeçare “Naun Doko” dhe ambulanca e Fshatit Marinëz). Me 61 subjekte janë nënshkruar marrëveshjet e dëmshpërblimit dhe u janë ekzekutuar shumat përkatëse. Tetë subjekte nuk janë dakord me masën e dëmshpërblimit të vlerësuar nga Komisioni i Vlerësimit dhe nuk

kanë pranuar të nënshkruajnë marrëveshje me Shoqërinë [REDAKTUAR], një pjesë e të cilëve janë në proces gjyqësor.

Në auditimin paraardhës, KLSH ka rekomanduar analizimin e teknologjive që përdoren nga Kontraktori dhe ndalimin e tyre duke reflektuar efektet negative të përdorimit të tyre sipas përcaktimeve në marrëveshjen hidrokarbure. Nga auditimi nuk rezulton të jenë marrë masat përkatëse për këtë qëllim, megjithëse fenomeni i lëkundjeve të tokës dhe dëmtimi i pronave të banorëve të zonës ka vazhduar. Për këto dëme, banorë e zonës kanë paraqitur ankesa në instancat e larta shtetërore përfshirë dhe KLSH. Albpetrol SHA e cila është palë në marrëveshjen hidrokarbure me Kontraktorin, nuk ka marrë masa për eliminimin dhe gjetjen e zgjidhjeve afatgjata të shqetësimeve banorëve të zonës (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

18.1. Albpetrol SHA në bashkëpunim me AKBN të marrin masa përkatëse, duke i kërkuar kontraktorit [REDAKTUAR] shpërblimin e plotë të dëmeve shkaktuar banorëve të zonës nga shpërthimi në pusin nr. 5761. Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure pranë Albpetrol, në bashkëpunim me agjencitë mjedisore, të marrin masa nëpërmjet monitorimit dhe inspektimeve në lidhje me rehabilitimin e mjedisit, cilësinë e ujërave nëntokësore dhe ajrit, për të eliminuar plotësisht pasojat e shpërthimit.

Vazhdimisht

18.2. Albpetrol SHA në bashkëpunim me AKBN të marrin masa të menjëhershme për ndalimin e përdorimit të teknologjive të papranueshme, të cilat kanë shkaktuar dëme të vazhdueshme për shëndetin dhe pronat e banorëve të zonës, si dhe të gjenden zgjidhje afatgjata për eliminimin e pasojave dhe mos përsëritjen e tyre.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Në marrëveshjen Hidrokarbure të nënshkruar ndërmjet Albpetrol SHA dhe [REDAKTUAR], neni 21.2 përcaktohet: “Kontraktori do të bëjë tendera konkurrues për ndonjë shërbim të kryer në përputhje me çështjet e përfshira në një Program Vjetor dhe Buxhet, nëse shërbime të tilla pritet të kalojnë vlerën 2 milionë USD. Albpetrol mund të ndjekë hapjen e ofertave për të gjithë tenderat e tillë”.

Albpetrol me shkresë nr. 8159 prot., datë 10.11.2015, ka theksuar faktin se, nga Albpetrol është kërkuar në mënyrë të përsëritur aplikimi i një sistemi prokurimi në përputhje me standardet ndërkombëtare të aplikuara në Industrinë e hidrokarbureve. Sa i përket punimeve të infrastrukturës është kërkuar në mënyrë të përsëritur zbatimi i legjislacionit vendas të fushës së ndërtimit. Çmimet e aplikuara për punimet e infrastrukturës janë në nivele shumë më të larta se çmimet e tregut ndërkombëtar apo vendor. Këto veprime janë konsideruar nga Albpetrol si thyerje marrëveshje dhe është bërë paralajmërimi përkatës, duke lënë një afat për marrjen e masave përkatëse sipas marrëveshjes për 6 muaj.

Pavarësisht nga sa më sipër, Albpetrol nuk ka rezultate mbi mbikëqyrjen e procesit të prokurimit të realizuara nga Kontraktori (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të marrë masa për të asistuar në të gjitha procedurat e tenderimit që zhvillohen nga Kontraktori [REDAKTUAR] për vlerën mbi 2 milionë USD sipas përcaktimeve në marrëveshjen hidrokarbure. Duke qenë se çmimet e aplikuara nga Kontraktori për punime dhe shërbime të ndryshme rezultojnë shumë më të larta se tregu, të sugjerohen kompani vendase të cilat kryejnë zbatime kontratash pranë Albpetrol dhe institucione të tjera për ekonomizimin e shpenzimeve që regjistrohen kosto hidrokarbure. Nëpërmjet auditimit, të reflektohen dhe zbriten vlerat e raportuara mbi tregun vendas për shërbime, punime apo mallra të cilat prokurohen nga kontraktori me çmime disa herë më të larta se tregu.

Mbi auditimin e zbatimit të Marrëveshjes Hidrokarbure për zonat Gorisht-Kocul, Cakran-Mollaj, Ballsh-Hekal dhe vendburimin e Delvinës”.

20. Gjetje nga auditimi: Tabela e faktorit R, sipas zonave dhe viteve të zbatimit të marrëveshjeve, paraqitet si më poshtë:

Për zonën Cakraj-Mollaj, koeficienti R ka ardhur në rritje deri në vitin 2014. Për zonën Ballsh-Hekal, koeficienti R deri në vitin 2010 ka ardhur në rritje, pastaj në zbritje. Për zonën Gorisht-Kocul koeficienti R ka ardhur në rritje duke e kaluar njësinë 1. Në vitin 2014, ky koeficient ka pasur rënie përsëri. Sa i përket vendburimit të Delvinës, ky koeficient është shumë i vogël. Për vendburimin e Gorisht-Kocul, rënia e koeficientit R pas vitit 2013, vjen si shkak i rritjes së shpenzimeve mbi të ardhurat, për të cilën Albpetrol duhet të ushtronte inspektime dhe audite, për të monitoruar nivelin e shpenzimeve, sepse ndërkohë që prodhimi është rritur në masën 50 %, niveli i investimeve është zvogëluar dhe përsëri raporti të ardhura shpenzime paraqitet në nivel më pak se 1.

Për zonën Gorisht-Kocul, kontraktori nuk ka paraqitur raportet e aktivitetit hidrokarbur, në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure për zonën Gorisht-Kocul. Nga ana e kontraktorit nuk janë paraqitur për miratim programet për vitin 2015 dhe 2016, në kundërshtim me marrëveshjet hidrokarbure përkatëse. Komiteti Këshillimor nuk është mbledhur nga data 22.04.2014, duke mos paraqitur pretendime në lidhje me aktivitetin hidrokarbur nga ana e Albpetrol dhe AKBN.

Sa më sipër rezulton se, vetëm për zonën Gorisht-Kocul faktori R është afër vlerës 1. Megjithëse në vitin 2012 dhe 2013, Faktori R për këtë zonë ka rezultuar më i madh se 1, në vitet pasuese ka ardhur përsëri në rënie, duke pamundësuar ndarjen e fitimit sipas marrëveshjes për këtë zonë.

Të ardhurat për vitin 2015 dhe 2016 kanë ardhur në rënie krahasuar me vitin 2014. Shpenzimet kapitale janë me zbritje, ndërsa shpenzimet operative kanë pësuar rritje. Mungesa e investimeve për këtë zonë, për të cilën shpenzimet operative janë në rritje, do të japin ndikim në uljen e prodhimit dhe më tej ulje të sasisë së naftës pjesë e Albpetrol.

Prodhimi për zonën Gorisht-Kocul, për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014 (për vitin 2016 nuk ka të dhëna) ka ardhur në rënie. Shpenzimet operative kanë pësuar rritje, nga 4,188 mijë USD në vitin 2014, në vitin 2015 janë shpenzuar 6,114 mijë USD. Shpenzimet kapitale nga 2,679 mijë USD në vitin 2014, në vitin 2015 janë realizuar me vlerë 219 mijë USD, pra kanë ardhur në rënie. Rritja e shpenzimeve operative krahasuar me ato kapitale nuk justifikohet, pasi prodhimi ka ardhur në rënie. Rënia e prodhimit lidhet me mos shpimin e puseve të reja dhe zvogëlimit të prodhimit të puseve ekzistues, pra si rezultat i mos shtimit të puseve të rinj, duhet të zvogëloheshin shpenzimet operative dhe jo të rriteshin.

Theksojmë faktin se, faktori R për këtë zonë, ka kaluar mbi 1 për vitin 2012 dhe 2013, ndërsa ka pësuar rënie në vazhdim të vitit 2014 dhe 2015.

Kalimi i faktorit R mbi 1 për këtë zonë, për vitin 2012 dhe 2013 është trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm. Është rekomanduar përlllogaritja e detyrimeve si dhe analizimi duke marrë masat e duhura për llogaritjen e vlerës së të ardhurave të kontraktorit mbi vlerën e shpenzimeve për vitin 2012 dhe 2013, si dhe njoftimi i organeve përkatëse shtetërore, për vlerën e detyrimit të ndarjes së fitimit. Gjithashtu, është rekomanduar që ky detyrim të sanksionohet edhe në amendimin e marrëveshjes “Për shuarjen, me kompensim të detyrimeve të ndërsjella ndërmjet Albpetrol SHA, kontraktorit, MF dhe MZHETTS”. Deri në momentin e auditimit nuk rezulton të jetë marrë masë për këtë qëllim. Ngarkohet me përgjegjësi Albpetrol dhe AKBN.

Për vendburimin e gazit, Delvinë, rezulton se nuk ka filluar akoma prodhimi i gazit, sipas përshkrimit në marrëveshje. Është realizuar vetëm prodhim kondensati. Për vitin 2014 është

prodhuar 30.48 ton kondensat, për vitin 2015 7.75 ton, ndërsa nuk ka të dhëna për vitin 2016.

Shpenzimet operative për vitin 2014 janë realizuar me vlerë 2,070 mijë USD, nga 1,683 mijë USD, ose me rritje në masën 19 %. Shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 12,305 mijë USD nga 23,568 mijë USD të programuara, me rënie në masën 52 %. Për vitin 2015 shpenzimet operative janë raportuar me vlerë 984 mijë USD, ndërsa shpenzimet kapitale me vlerë 9,733 mijë USD. Për vitin 2016 (6-mujori i I), shpenzimet operative janë raportuar me vlerë 161 mijë USD dhe shpenzimet kapitale me vlerë (-) 28.9 mijë USD.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se, për vitin 2014 dhe 2015, shpenzimet e raportuara (OPEX + CAPEX) nuk justifikojnë aktivitetin e realizuar në këtë zonë, duke patur në konsideratë faktin se, prodhimi i gazit është zero, ndërsa prodhimi i kondensatit është në sasi shumë të vogla, për vitin 2015, vetëm 7.75 ton, ndërsa për vitin 2016 nuk është prodhuar (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

20.1. Nga ana e Albpetrol të auditohen llogaritë e kontraktorit duke filluar nga raporti i katërt i vitit 2014 e në vazhdim, duke zbritur kostot hidrokarbure të regjistruara në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure.

20.2. Të analizohet rritja e shpenzimeve të paraqitura nga kontraktori duke filluar nga viti 2013, shpenzime të cilat janë rritur me arsyetimin e rritjes së prodhimit, rritja e cila është shumë e vogël në krahasime rritjen e prodhimit, veçanërisht për zonën Gorisht-Kocul.

20.3. Të realizohen monitorime dhe inspektime të vazhdueshme të operacioneve hidrokarbure të kontraktorit, në mënyrë që t'i ndërpritet mundësia e abuzimeve me kostot hidrokarbure.

Vazhdimisht

21. Gjetje nga auditimi: Kompania [REDAKTUAR], nëpërmjet shkresës nr. 383/16 prot., datë 16.12.2016, drejtuar KLSH dhe për dijeni Albpetrol SHA, MEI dhe AKBN, ka kërkuar dhënien e mundësisë për kompensimin e detyrimeve nga vendburime të ndryshme, për llogari të prodhimit PEP + ASP. Nga Kontraktori theksohet se, kjo metodë është ndjekur nga Albpetrol në rakordimin e detyrimeve për vitin 2014 me Kompaninë [REDAKTUAR]. Kjo procedurë është ndjekur për arsye teknike dhe praktike, pasi kushtet ekzistuese të organizimit të kapaciteteve depozituese dhe të pikave të lëvrimin, paraqesin probleme në zbatimin e procedurave të lëvrimin për çdo vendburim, si dhe lëvrimi i sasive të naftës brut nga vendburimi i Gorisht-Kocul në krahasim me vendburimin e Ballsh-Hekal, ka një kosto më të madhe për Albpetrol SHA. Ky veprim konsiderohet nga Kontraktori se jep fleksibilitet më të madh dhe nuk përbën asnjë parregullsi (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të marrë masa për të hyrë në marrëveshje me Kompaninë [REDAKTUAR] për shlyerjen e detyrimeve mujore për llogari të prodhimit PEP + ASP, për vendburime të ndryshme sipas marrëveshjeve hidrokarbure, duke ruajtur në çdo rast interesat e Albpetrol SHA dhe të shtetit shqiptar.

Në vazhdimësi

22. Gjetje nga auditimi: Kompania [REDAKTUAR], bashkëngjitur shkresës nr. 383/16 prot., datë 16.12.2016, drejtuar KLSH dhe për dijeni Albpetrol SHA, MEI dhe AKBN, ka paraqitur disa pretendime për veprime të Albpetrol ndaj kompanisë, të konsideruara nga ana e saj si veprime tendencioze, që kanë ndikuar negativisht në performimin e marrëveshjeve hidrokarbure.

Kryesisht këto pretendime kanë të bëjnë me:

-Njoftimin e Albpetrol SHA për thyerje materiale të detyrimeve themelore të marrëveshjeve hidrokarbure për zonat Gorisht-Kocul dhe Cakran-Mollaj, në lidhje me detyrimet e akumuluar nga kompania. Nga kompania pretendohet se nuk janë marrë në konsideratë pretendimet e saj në kushtet kur edhe Albpetrol SHA ka detyrime ndaj Kompanisë [REDAKTUAR].

- Refuzimin e Albpetrol për të vënë në dispozicion të kontraktorit të rrjetit elektrik për zonë Cakran-Mollaj dhe faturimet e energjisë elektrike në masën 70 % të çmimit të OSHEE. Duke filluar nga muaji qershor 2016, ka patur ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike nga Albpetrol, për shkak të ndonjë vonese në likuidimin e faturave, të cilat janë shoqëruar me ndalim dhe humbje të prodhimit të naftës brut në rreth 1200 ton.

- Kontraktori konsideron të papranueshëm faktin se, ndërkohë që është nënshkruar një marrëveshje për shuarjen me kompensim të detyrimeve, angazhohen përmbarues për marrjen me forcë të detyrimeve dhe bllokim të aktivitetit të shitjes së naftës brut.

- Mosnjohja e forcës madhore, faturimi i kostos së përgatitjes së të dhënave etj. (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA, të marrë masa dhe të analizojë në mënyrë të detajuar pretendimet e kontraktorit [REDAKTUAR] sipas përcaktimeve në marrëveshjet hidrokarbure, duke mbajtur në konsideratë të drejtat dhe detyrimet e palëve, duke mbrojtur dhe mbajtur në konsideratë interesat e shtetit shqiptar. Këto çështje të diskutohen edhe në minutat e takimit të komitetit këshillimor dhe të merren vendimet përkatëse në dobi të mbarëvajtjes së marrëveshjeve hidrokarbure dhe arritjes së përfitimeve për shtetin shqiptar.

Brenda 3 mujorit të I^ë 2017

- Mbi zbatimin e procedurave ligjore për dhënien me qira të ambienteve si dhe zbatimin i kushteve të kontratës.

23. Gjetje nga auditimi: Nga qendrat (njësitë vartëse) në administrim të Albpetrol SHA, nuk është proceduar me organet kompetente, për lirimin dhe dorëzimin e ambienteve brenda afateve të njoftimit për lirim të urdhëruar prej tyre, në kundërshtim me shkresën nr. 612, datë 26.01.2015 të Albpetrol SHA, referuar dhe faktit se ky proces nuk është monitoruar për vazhdimësinë e tij dhe raportuar në organet drejtuese të shoqërisë nga Drejtoria e ARP dhe Drejtoria Juridike, në kundërshtim me detyrat funksionale të përcaktuara në rregulloren e brendshme (trajtuar më hollësisht në faqet 229-235 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekë dhe monitorojë në mënyrë të vazhdueshme të gjitha proceset, duke kërkuar nga institucionet kompetente marrjen e masave sipas ligjit për lirimin dhe kthimin e pronave në administrim të Albpetrol SHA. Për sa më sipër të raportohet vazhdimisht në organet drejtuese dhe administratori i shoqërisë.

Vazhdimisht

24. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me procedurat e përgatitjes së dosjeve për dhënien me qira rezultoi se kanë disa mangësi si në dokumentacion ashtu dhe në procedurën e dhënies me qira. Kryesisht dokumentacioni i mëposhtëm është më mangësi ose i pa rregullt.

-Kërkesa për marrjen me qira

-Plani i Biznesit

-Vërtetim nga D.P.Tatimeve

-Certifikatë Regjistrimi NUIS

-Gent-Plani i pronës

Nga ana e Albpetrol SHA, është mjaftuar vetëm me një kërkesë të paraqitur nga subjekti për marrjen me qira për miratimin e kontratave të qirasë në kundërshtim me V.K.M Nr. 54, datë

5.2.2014 kapitulli II pika 1 dhe 7 të këtij vendimi (trajtuar më hollësisht në faqet 229-235 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës, Drejtoria Juridike si dhe nga drejtuesit e shoqërisë të kualifikohen dhe pranohen ato kërkesa për marrje me qira të cilat plotësojnë kushtet sipas V.K.M Nr. 54, datë 5.2.2014.

Vazhdimisht

A.III - Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

25. Gjetje nga auditimi: Shoqëria Albpétrol SHA nuk ka plotësuar dhe dërguar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Industrisë pyetësonin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kap V “Shtojcat”, Shtojca 2 – Pyetësoni i vetë-vlerësimit për komponentët e MFK-së.

-nuk ka hartuar dhe miratuar planin strategjik i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit;

-nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, rregullore apo, udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara;

-nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre;

-nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut, e për pasojë drejtuesit, nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut;

- nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave (trajtuar më hollësisht në faqet 235-239 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

25.1. Shoqëria Albpétrol SHA, të miratojë rregulloren për zbatimin e Kodit të Etikës në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përcaktuar njëkohësisht masat disiplinore dhe strukturat vendimmarrëse për punonjësit shkelës të rregullave të etikës.

25.2 Shoqëria Albpétrol SHA të marrë masat e duhura për të bërë ndryshimin e rregullores së brendshme në përshtatje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, si dhe në përputhje me strukturën organike të shoqërisë me qëllim që, të mos ketë ndryshime midis strukturave të përcaktuara sipas organikës me ato të përcaktuara në rregullore. Me akte administrative të brendshme, të përcaktojë delegimin e kompetencave apo të detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Deri me datë 31.03.2017

26. Gjetje nga auditimi: Albpétrol SHA nuk ka marrë masa si më poshtë:

-Nuk është hartuar manuali specifik dhe karta e Auditit të Brendshëm të Albpétrol SHA;

-Nuk ka asnjë informacion nga subjektet në lidhje me pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve, pasi në një pjesë të rasteve nuk ka shkresë përcjellëse të vënies në dispozicion të tyre;

-Mungojnë në disa dosje programet e punës për angazhimet (misionet) e auditimeve të kryera.

-Nuk është bërë ndarja e detyrave dhe përcaktimi i përgjegjësive individuale të audituesve gjatë angazhimit të auditimit (trajtuar më hollësisht në faqet 235-239 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës, Administratori Shoqërisë dhe Drejtorja e Auditit të Brendshëm, të marrin masa për hartimin e manualit specifik dhe kartës së Auditit të Brendshëm të Albpetrol SHA, zbatimin e standardeve të auditimit në organizimin, funksionimin, rekrutimin e stafit dhe në të gjitha fazat e procesit të auditimit, në zbatim të Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe UMF nr. 12 datë 05.06.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Deri me datë 31.03.2017

- Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se: Sa i përket masave organizative, janë realizuar 5 rekomandime, nuk është realizuar 1 dhe janë në proces zbatimi 21 rekomandime. Sa i përket masave shpërblim dëmi, janë realizuar 5 rekomandime, nuk është realizuar 1 dhe janë në proces zbatimi 9 rekomandime.

Masat disiplinore janë realizuar 7 dhe nuk janë realizuar 10 (trajtuar më hollësisht në faqet 28-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

27.1 Albpetrol SHA të marrë masat përkatëse për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë në proces si dhe nuk janë realizuar.

Menjëherë

27.2. Albpetrol SHA të kërkojë pjesëmarrjen e KLSH si palë e tretë në çdo proces gjyqësor të iniciuar në bazë të rekomandimeve të KLSH, pasi siç rezultoi edhe nga ballafaqimi ekzistojnë dyshime të forta për nivelin e mbrojtjes së interesave të shtetit nga Albpetrol në këto procese gjyqësore dhe për rrjedhojë shtrohet si domosdoshmëri prezenca e KLSH.

Vazhdimisht

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Gjatë auditimit është konstatuar dëm ekonomik, kosto hidrokarbure të pa rikuperueshme dhe të ardhura të munguara me vlerë 15,108,418 mijë lekë. Në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

B.I - Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës, vendimet e marra prej tij dhe zbatimi i tyre.

1. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se anëtarëve të këshillit mbikëqyrës nga ana e Albpetrol SHA ju janë dhënë gazoil, mesatarisht 400 litra në muaj: 100 për kryetarin dhe nga 60 për anëtarët. Një veprim i tillë është kryer sipas Vendimit të Administratorit të Albpetrol SHA nr. 317, datë 04.11.2013, me nr. 3762 prot., nga miratimi i shtesës së limitit për administratën e Albpetrol SHA me destinacion këshillin mbikëqyrës në sasinë 400 litra në muaj, ***në tejkalim të kompetencave të tij duke ngarkuar me përgjegjësi z. E.P.*** Përfitimet e këshillit mbikëqyrës i përcakton VKM nr. 642, datë 11.10.2005 i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 318, datë 8.4.2009.

Përfitimi i mësipërm nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës është në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 642, datë 11.10.2005, “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore” i ndryshuar, pika 6/a dhe paragrafit i fundit të pikës 6/ç, si dhe Udhëzimit të ministrit të METE nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu V, pika 1 dhe 3, pasi këshilli mbikëqyrës përfiton shpërblim mujor për pjesëmarrje në këto këshilla, si dhe për detyra të anëtarëve të këshillit të ngarkuara nga këshilli mbikëqyrës të vërtetuara në materialet dokumentare shkresore, anëtarit i rimburohet vlera e shpenzimit. Veç këtyre duhet të theksojmë se këshilli mbikëqyrës i ka të gjitha mundësitë për zhvillimin e mbledhjeve dhe në Tiranë, pasi Albpetrol SHA ka zyra dhe atje, për më tepër që 70 % e aktivitetit në 15 muajt e fundit është kryer me nënshkrimin e vendimeve qarkulluese, si dhe karburanti për vitin 2014 ju është dhënë në fillim të vitit 2015.

Në total, nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës është përfituar padrejtësisht vlera 1,800,120 lekë, pasi është në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 642, datë 11.10.2005, “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore” i ndryshuar, pika 6/a dhe paragrafit të fundit të kësaj pike, si dhe në kundërshtim me Udhëzimin e ministrit të METE nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu V, pika 1 dhe 3, dhe përbën dëm ekonomik për Albpetrol SHA (trajtuar më hollësisht në faqet 43-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **1,800,120 lekë** përfituar padrejtësisht nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës, për sasi të gazoililit të tërhequr nga shoqëria për periudhë viti 2014 deri më 30.09.2016, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005, si më poshtë:*

Nr.	Emri Mbiemri	Sasia për 01.01.2014 - 30.09.2016 (litra)	Vlerësuar gjithsej (lekë)
1	K.B	3,000	450,000
2	K.B	120	18,000
3	D.S	1,740	261,000
4	A.M	1,080	162,000
5	A.Ç	1,500	225,000
6	A.K	480	72,000
7	A.O	1,860	279,000
8	E.K	1,200	180,000
9	I.Sh	360	54,000
10	E.Q	360	54,000
11	E.E	180	27,000
12	A.C	120	18,120
Gjithsej		12,000	1,800,120

Menjëherë

B.II - Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.

2. Gjetje nga auditimi: Këshilli Tekniko-Shkencor i Albpetrol SHA përbëhet nga 15 anëtarë nga të cilët 9 janë punonjës të Albpetrol SHA dhe 6 janë pedagogë të Universitetit Politeknik të Tiranës, sipas vendimit të Administratorit nr. 65, datë 02.12.2013 me ndryshimet e mëvonshme. Pagesa e tyre mujore prej 5,000 lekë bëhet sipas vendimit të Administratorit nr. 371, datë 13.12.2013.

Referuar vendimeve të Drejtorit Ekzekutiv të vitit 2004 për ngritjen dhe shpërblimin e këshillit teknik të qendrave, janë paguar me nga 2,000 lekë në muaj nga 5-7 punonjës sipas sipas qendrave. Mbi këtë bazë, në periudhën korrik 2015 - shtator 2016 kanë përfituar shtesë page në administratën e Albpetrol SHA 10 punonjës në shumën 640,000 lekë, si dhe në qendra 1,121,453 lekë, pra gjithsej në shumën 1,761,453 lekë përfitime nga punonjës në cilësinë e anëtarëve të këshillave tekniko-shkencore.

Shpërblime të tilla mbi pagën e vendit të punës e drejtuesve dhe e një pjese të vogël të stafit menaxhues është i kundërligjshëm, pasi në kontratën e individuale të punës është përcaktuar që punëmarrësi pranon të punojë në pozicionin përkatës të punës pranë Albpetrol SHA (neni 4.1). Në këtë mënyrë, pjesëmarrja e punonjësit të Albpetrol SHA në Këshillin Shkencor është brenda detyrës funksionale të tij, për më tepër që zhvillimi i këtyre mbledhjeve bëhet brenda kohës normale të punës (neni 7 i kontratës individuale). Pagesa të tilla të kryera në periudhën korrik 2015 - shtator 2016 për këshillat teknike **në shumën 1,761,453 lekë përbëjnë dëm ekonomik për Albpetrol SHA** (trajtuar më hollësisht në faqet 47-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **1,761,453 lekë** përfituar padrejtësisht nga anëtarët e këshillit teknik, në kundërshtim me kontratën individuale të punës, neni 4.1.*

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Administratori z. E. P. ka marrë Vendimin nr. 703, datë 10.12.2014 për pagesën e kualifikimit/gradave dhe titujve me shuma nga 11,000 deri në 25,000 lekë, për drejtuesit të cilëve u përputhet titulli i marrë me detyrat e vendit të punës, të bazuar në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë (2) Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të këshillit të ministrave/kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, i ndryshuar. Referenca në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 është e gabuar, pasi ky vendim ju referohet nëpunësve civil të administratës publike dhe nuk përbën detyrim për punonjësit e shoqërive aksionare, marrëdhëniet e punës të cilëve bazohen mbi Kodin e Punës. Veç kësaj, ky VKM përcakton se: - Kjo shtesë jepet kur kualifikimi, grada apo titulli shkencor përputhen me përshkrimin e punës së nëpunësit...” (paragrafi i dytë i pikës 2/c), dhe në asnjë rast në Rregulloren e brendshme të funksionimit të Albpetrol SHA, asnjë pozicion pune nuk kërkon zotërimin e kualifikimit, gradës apo titullit shkencor.

Gjatë auditimit të dokumentacionit të pagave për periudhën 01.07.2015 deri më 30.09.2016, u konstatua se kanë përfituar shpërblim për titullin master shkencor dhe master profesional si dhe doktor i shkencave me vlerë 1,145,500 lekë.

Pagesat e mësipërme janë përfituar në mënyrë të kundërligjshme, pasi janë përdorur referenca të gabuara të VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve...” **dhe në këtë mënyrë shuma 1,145,500 lekë përbën dëm ekonomik për Albpetrol SHA** (trajtuar më hollësisht në faqet 47-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **1,145,500 lekë** përfituar padrejtësisht nga punonjësit e Albpetrol SHA për titullin master shkencor, master profesional dhe doktor i shkencave si më poshtë:*

Nr.	Emri Mbiemri	Kualifikimi	Pagesa mujore (lekë)	Pagesa 01.07.2015 - 30.09.2016 (lekë)
1	E.P	Master shkencor	14,000	210,000
2	F.G	Doktor Shkencash	20,000	300,000
3	D.F	Master shkencor	14,000	210,000
4	Th.M	Master shkencor	14,000	210,000
5	A.H	Master shkencor	14,000	95,000
6	O.K	Master shkencor	14,000	95,000
7	E.F	Master profesional	11,000	160,500
8	J.Gj	Master profesional	11,000	165,000

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Janë bërë pagesa për biletat e transportit të punonjësve në qendrat e punës, në pagën mujore të përfituesve, në vitin 2015, për një total në vlerën **26,122,520 lekë**, veprim i autorizuar me urdhrin e administratorit z. E.P. nr.380/1 prot, datë 04.02.2014. Sipas këtij urdhri pagesa e shpenzimeve për transportin e punonjësve kryhet në përputhje me nenin 126, pika 1 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ku citohet se “...punëdhënësi rimbursion punëmarrësin për të gjitha shpenzimet që rrjedhin nga kryerja e punës”, dhe nenin 128, pika 1 ku citohet se: “Rimbursimi i shpenzimeve do të jepet në të njëjtën kohë me pagën mbi bazën e përlllogaritjes së punëmarrësit, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në marrëveshje”, si dhe tarifat e transportit të miratuara me VKM nr.66, më datë 07.02.2007. Pagesat do të kryhen në listëpagesat e pagave të punonjësve në fund të çdo muaji, pa u mbajtur tatimi dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore.

Neni 126 i ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “ Shpenzimet” citon:

- 1. Punëdhënësi rimbursion punëmarrësin për të gjitha shpenzimet që rrjedhin nga kryerja e punës. Kur punëmarrësi dërgohet të punojë jashtë vendit të tij të punës, punëdhënësi i paguan atij shpenzimet e nevojshme për këtë rast.*
- 2. Kontrata kolektive e punës ose kontrata e shkruar mund të mund të parashikojë që shpenzimet e kryera nga vetë punëmarrësi, do t'i paguhen në formën e një shume të caktuar si paradhënie e përlllogaritjes mbi bazën e një dite pune, një javë ose një muaji. Rregullimi i përlllogaritjes është i vlefshëm vetëm në rastet kur ajo mbulon të gjitha shpenzimet e nevojshme.*
- 3. Janë të pavlefshme kontratat që parashikojnë përfshirjen pjesërisht ose tërësisht të rimbursimit në pagën e punëmarrësit.*
- 4. Janë të pavlefshme kontratat në bazë të të cilave punëmarrësi duhet të përballojë vetë të gjitha shpenzimet ose një pjesë të tyre.*

Interpretimi i kryer nga titullari i Albpetrol SHA z. E. P. është i gabuar dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi ligji parashikon shpenzimet që rrjedhin për kryerjen e punës dhe jo për mbërritjen në vendin e punës. Në pjesën e dytë të pikës 1 të nenit 126 sqarohet se kur punëmarrësi dërgohet të punojë jashtë vendit të tij të punës, punëdhënësi i paguan atij shpenzimet e nevojshme për këtë rast.

Shoqëria për vitin ushtrimor 2015 ka pasur gjithsej shpenzime në vlerën **26,122,520 lekë** për transportin e punonjësve. **Nga kjo vlerë 4,672,000 lekë janë paguar për punonjës me banim në Tiranë. Këtyre punonjësve i janë paguar shpenzime për transportin dhe jo dieta ditore.**

Me urdhrin nr. 123, datë 08.01.2016 administratori z. E.P. e ka anuluar pagesën për shpenzime transporti për punonjësit për mbërritjen në qendrat e punës për vitin 2016 (trajtuar më hollësisht në faqet 86-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i Albpetrol SHA dhe Drejtoria Ekonomike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative për arkëtimin e shumës 26,122,520 lekë, të përfutur padrejtësisht nga punonjësit e Albpetrol SHA gjatë vitit 2015.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 1.01.2015 deri më 30.09.2016 mbi çështjet gjyqësore të punonjësve, rezultoi se në Gjykatën e Lartë kanë përfunduar 12 çështje në favor të punonjësve për të dëmshpërblyer nga 8 - 17.5 paga vjetore secilin, si dhe kanë përfunduar 8 çështje në Gjykatën e Apelit. Gjithashtu, janë në proces 143 raste të tjera, nga të cilët 33 janë në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe 110 punonjës të tjerë janë në Gjykatën e Apelit.

Në periudhën nga data 01.07.2015 deri me 30.09.2016 janë paguar 79 punonjës për vendime gjyqësore të largimeve nga puna pa shkaqe të arsyeshme të periudhave të mëparshme në shumën 58,448,661 lekë, e cila ka rritur kostot e shoqërisë. Në 40 raste zbatimi i vendimeve gjyqësore është bërë nëpërmjet zyrave përmbartimore duke rritur akoma më shumë koston e këtyre largimeve pa shkaqe të përligjura (trajtuar më hollësisht në faqet 47-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA të analizojë largimet e paligjshme nga puna të punonjësve dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse për mos respektimin e kërkesave të kontratave individuale të punës dhe përcaktimet e Kodit të Punës, të cilat për periudhën e audituar kanë rënduar shpenzimet në shumën 58,448,661 lekë, me qëllim mos rritjen e kostove të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdim

B.III - Mbi analizën e bilancit të naftës brut.

6. Gjetje nga auditimi: Nga ana e QASHNG Patos, shuma e firove të llogaritura tej firove ligjore për periudhën 01.07.2015-30.09.2016, në sasinë 121.66 ton dhe vlerën 2,676,455 lekë (e llogaritur me çmimin e brendshëm të përdorur nga QASHNG Patos 22,000 lekë/ton), përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit dhe shoqërinë Albpetrol SHA, e si e tillë duhet të dëmshpërblehet. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, i ndryshuar (trajtuar më hollësisht në faqet 57-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 2,676,455 lekë, nga anëtarët e Këshillit Teknik për zbritjen nga bilanci i naftës bruto të periudhës 01.07.2015-30.09.2016, të sasisë 121.66 ton naftë, si firo transporti dhe magazinimi mbi normave e përcaktuara ligjore.

Deri me datë 31.03.2017

B. IV - Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit dhe zbatimin e kontratave.

7. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtim RVM 5000 m³/11 të ri, me sistem ngrohje e termoizolim dhe punime ndërtimore, mjedisore e teknologjike, në stacionin e naftës Zharrëz të QASHNG, Patos”, shtesë kontrate, viti 2016.

Gjetje nga auditimi: AK në kundërshtim të plotë më ligjin, ka nënshkruar shtesë kontrate për një objekt i cili është kolauduar dhe marrë në dorëzim më parë, **duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 21,603,002 lekë.**

AK në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, ka nxjerrë urdhrin e prokurimit, në të cilin nuk janë dhënë të detajuara arsyet e përdorimit të procedurës. Gjithashtu, ka përzgjedhur procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, ndërkohë nuk argumentohet përdorimi i saj.

AK nuk ka mbajtur dokumentacionin e tenderit, në përdorimin e kësaj procedure.

AK në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, nuk ka përcaktuar në ftesën për ofertë të gjithë elementët e parashikuar në dispozitat nënligjore në fuqi.

AK nuk ka nxjerrë një urdhër të veçantë për ngritjen e KVO.

AK në kundërshtim të plotë me dispozitat e prokurimit publik, nuk duhej të kishte nënshkruar kontratën me shoqërinë e vetme të ftuar në tender, si dhe duhej të ishte mbajtur raporti përmbledhës, kjo në kushtet kur argumentimi i procedurës, nuk gjen mbështetje ligjore, si dhe është titullari i AK i cili bën edhe miratimin e tij (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA të shqyrtojë vlerën 21,603,002 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit “Ndërtim RVM 5000 m3/11 të ri, me sistem ngrohje e termoizolim dhe punime ndërtimore, mjedisore e teknologjike, në stacionin e naftës Zharrëz të QASHNG, Patos”, shtesë kontrate, viti 2016”, u konstatua se nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, pasi janë rritur në mënyrë të pa argumentuar dhe të pa bazuar ligjërisht shpenzimet në fazën e përllogaritjes së fondit limit, si pasojë e së cilës është rënduar padrejtësisht kostoja e investimit me vlerë 21,603,002 lekë. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për shoqërinë Albpetrol SHA dhe buxhetin e shtetit përbën dëm ekonomik.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit me objekt “Blerje GPS personal, GPS për automjete, sensorë të matjes së konsumit të karburantit” viti 2014, sipas kontratës së lidhur midis Albpetrol SHA dhe “██████ sh.p.k, u konstatua se malli i prokuruar ka ardhur pjesë pjesë dhe në të gjitha rastet me ditë vonesë. Sasia e mallit që ka ardhur 8 ditë me vonesë, ka vlerën e 4,488,000 lekë. Sasia e mallit që ka ardhur me 122 ditë vonesë, ka vlerën e 3,600,000 lekë. Sasia e mallit që ka ardhur me 168 ditë vonesë, ka vlerën e 13,464,000 lekë. **Në total, sipas kalkulimeve, vlera e penalitetit kap shifrën e 10,948,224 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 10,948,224 lekë dëm ekonomik, nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ██████, për vonesa në dorëzimin e mallit, sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Tenderi “Blerje automjete” të vitit 2014 është shoqëruar me mangësi nga komisioni i specifikimeve teknike në lidhje me mos vendosjen e afatit të garancisë prej 3 vitesh; mangësi të veprimtarisë së KVO si zgjatja e periudhës së vlerësimit dhe klasifikimit të ofertave jashtë afateve ligjore, në autorizime e certifikata etj; mangësi të komisionit të kolaudit, duke pranuar mallra me ndryshime të specifikimeve teknike nga ato të ofertuar, si dhe shtyrje të afatit të dorëzimit të mallrave pa shkaqe të përligjura, duke favorizuar bashkimin e operatorëve fitues ██████ dhe mos penalizuar për dorëzim të vonuar të automjeteve, **me vlerë 9,409,167 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 9,409,167 lekë dëm

ekonomik, nga bashkimi i operatorëve ekonomikë [REDAKTUAR], penalitetet për vonesa në dorëzimin e automjeteve sipas përcaktimeve kontraktore.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit me objekt “Shërbimi i remonteve kapitale të puseve” viti 2015, u konstatua se janë faturuar në favor të operatorit ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k., zëra punimesh të cilat nuk kanë asnjë lidhje me objektin e kontratës në vlerën **6,784,560 lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Shoqërinë e Albpetrol SHA** (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **6,784,560 lekë dëm ekonomik, nga operatori ekonomik [REDAKTUAR] Sh.p.k, për punime të likuiduara dhe të pa justifikuar, në kundërshtim me kontratën.***

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Garanci doganore për magazinat fiskale”, viti 2016, AK në kundërshtim të plotë më dispozitat e prokurimit publik, ka përcaktuar një fond limit të paargumentuar dhe të pa dokumentuar. Nuk janë marrë në konsideratë kontratat e lidhur më parë nga shoqëria, duke përcaktuar një fond limit më të lartë, duke shkaktuar dëm ekonomik me **vlerë 5,281,028 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumës prej **5,281,028 lekë dëm ekonomik nga znj. K.L, znj. A.B, z. P.B, z. A.H, z. D.Gj, z. A.S, z. N.N, si dhe z. E.P.***

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Albpetrol SHA gjatë vitit 2016 i ka shitur produktin hidrokarbur, naftë brut shoqërisë [REDAKTUAR]. bazuar në kontratën me nr. 531/10 datë 02.03.2016. Në aneksin nr. 1 të kësaj kontrate janë përcaktuar dhe afatet e tërheqjes së mallit, për periudhën 02.03.2016-31.05.2016 janë parashikuar të tërhiqen 7500 ton naftë brut. Gjatë kësaj periudhe janë tërhequr 264 ton naftë. Sasitë e kontraktuara janë tërhequr në muajin gusht e shtator. Shoqëria [REDAKTUAR] nuk ka zbatuar kontratën për sasinë prej 7236 ton.

Mos tërheqja e sasive të kontraktuara ka shkaktuar vështirësi në likuiditetin financiar të shoqërisë Albpetrol SHA. Në pikën 5.10 të kontratës citohet se : “Në rast të mos kryerjes së pagesës sipas afateve të përcaktuara në këtë kontratë apo në rast të mos tërheqjes së sasisë së mallit sipas mënyrës (siç parashikohet në Aneksin nr.1), blerësi është dakord me penalitetet ditore që do të llogariten sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare””.

Përqindja e vendosur nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit të vitit 2015 për normat e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella) është 1.75 %. Kësaj përqindje i shtohen dhe tetë pikë duke pasur një përqindje prej 9.75 %. Sasia 7,236 ton është vlerësuar me çmimin mesatar të periudhës dhe jep vlerën 166,139,271 lekë. Numri i ditëve është 92, përqindja 9.75 në bazë vjetore Penaliteti i pa mbajtur për kontraktorin për mos tërheqjen e sasisë së naftës brut

sipas grafikut të përcaktuar në kontratë është **4,082,929 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyimit, arkëtimi i vlerës **4,082,929 lekë** dëm ekonomik, nga operatori ekonomik █████ sh.p.k për furnizime të pa tërhequra në afatin e përcaktuar nënkontratë.*

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit me objekt “Riparim i zyrave të sektorit 3, sektorit 5, të QPN Kuçovë” viti 2014, sipas kontratës së lidhur midis Albpetrol SHA dhe █████ sh.p.k., u konstatuan vonesa në afatet e ekzekutimit të punimeve me 7 ditë të cilat kalkulohen sipas nenit 3 të kontratës bazë, pikës 3.22 ku citohet se: “Për çdo ditë vonesë të kryerjes së punimeve të shkaktuar për faj të sipërmarrësit tej afatit të caktuar, sipërmarrësi është i detyruar ti paguajë investitorit, penalitet 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por jo më pak se 25% të vlerës”. **Si rezultat, penaliteti që i duhet mbajtur bashkimit të operatorëve ekonomik █████ sh.p.k., është me vlerë 171,628 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyimit, arkëtimi i vlerës **171,628 lekë** dëm ekonomik, nga bashkimi i operatorëve ekonomikë █████ sh.p.k për punime të pa përfunduara në afatin e përcaktuar nënkontratë.*

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit me objekt “Ndërtim RVM 5000 m³ të ri” me sistem ngrohje dhe termoizolim, për vitin 2015, sipas kontratës së lidhur midis Albpetrol SHA dhe █████ sh.p.k., u konstatuan diferenca në zëra punimesh të cilat kapin **vlerën e 131,827 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik** (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyimit, arkëtimi i vlerës **131,827 lekë** dëm ekonomik, nga bashkimi i operatorëve ekonomikë █████ sh.p.k për punime likuiduara, por të pa realizuara sipas kontratës.*

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Riparim, hidroizolim zyrash QPN Kuçovë”, viti 2014, AK në kundërshtim të plotë më dispozitat e prokurimit publik, ka përcaktuar një fond limit të paargumentuar dhe të pa dokumentuar. AK ka përlloritur një fond limit të tejfryrë, i cili i ka shkaktuar një dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA, me vlerë **854,899 lekë**.

AK në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, ka përcaktuar në urdhrin e prokurimit, edhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, AK nuk ka argumentuar dhe dokumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, duke mos mbajtur procesverbalin mbi vendosjen e kritereve për kualifikim, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës.

AK në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, nuk ka nënshkruar dokumentet e tenderit në çdo faqe.

Kriteret për kualifikim, të hartuara nga AK, janë diskriminuese dhe në kundërshtim me ligjin.

AK ka tejkeluar afatin 5 ditor lidhur me procesin e vlerësimit të ofertave.

AK, në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP, ka kualifikuar shoqëri, të cilat nuk plotësojnë kriteret për kualifikim, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë **356,640 lekë**.

AK në kundërshtim të plotë me dispozitat e prokurimit publik, nuk duhej të kishte nënshkruar kontratën me shoqërinë kualifikuar në tender, si dhe nuk duhej të kishte bërë miratimin e raportit përmbledhës.

AK në kundërshtim të plotë me dispozitat e prokurimit publik, nuk ka zbatuar formulën për ofertat anomalisht të ulëta (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

15.1. Albpetrol SHA. të kërkojë në rruge ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumës prej 854,899 lekë dëm ekonomik nga znj. R.G, z. M.R, z. A.H, z. N.N, znj. E.P, z. E.P.

15.2. Albpetrol SHA. të kërkojë në rruge ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumës prej 356,640 lekë dëm ekonomik nga z.D.Gj, z. G.N, z. N.N dhe z. E.P.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës “Shërbimi i transportit të naftës brut”, ka rezultuar se sipas faturës nr. 11 (20034943), datë 02.05.2016, në pagesat e kontraktorit është përfshirë transport i pa realizuar për sasinë 187.96 ton, për distancën 72 kilometë, për destinacionin Gorisht-Zharrëz, Vlera koresponduese në shumën **292,315 lekë me TVSH**, është në kundërshtim me kontratën dhe përbën dëm ekonomik (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA në certifikatën pasardhëse të pagesave të bëjë zbritjen e vlerës 292,315 lekë dëm ekonomik, nga bashkimi i operatorëve ekonomikë █████ sh.p.k për transport të likuiduar dhe të pa realizuar.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Shtesë kontrate, garanci doganore të magazinave fiskale”, viti 2016, AK në kundërshtim të plotë me dispozitat e prokurimit publik, ka përcaktuar një fond limit të paargumentuar dhe të pa dokumentuar, duke shkaktuar **dëm ekonomik me vlerë 61,969 lekë**.

AK në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, ka nxjerrë urdhrin e prokurimit, në të cilin dispozitat ligjore të përdorura, janë të gabuara. Gjithashtu, ka përzgjedhur procedurën më negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, ndërkohë nuk argumentohet përdorimi i saj.

AK nuk ka mbajtur dokumentacionin e tenderit, në përdorimin e kësaj procedure.

AK në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, nuk ka përcaktuar në ftesën për ofertë të gjithë elementët e parashikuar në dispozitat nënligjore në fuqi.

AK nuk ka nxjerrë një urdhër të veçantë për ngritjen e KVO.

AK në kundërshtim të plotë me dispozitat e prokurimit publik, nuk duhej të kishte nënshkruar kontratën me shoqërinë e vetme të ftuar në tender, si dhe duhej të ishte mbajtur raporti përmbledhës, kjo në kushtet kur argumentimi i procedurës, nuk gjen mbështetje ligjore, si dhe është titullari i AK i cili bën edhe miratimin e tij (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA. të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumës prej 61,969 lekë dëm ekonomik nga z. N.N, z. D.Gj, z. A.H, znj. A.B, z. P.B, z.A.S, si dhe z. E.P.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit me objekt “Blerje gomash automjetesh” viti 2015, u konstatuan vonesa në afatet e ekzekutimit të kontratës së lidhur midis Albpetrol SHA dhe █████ sh.p.k., u konstatua se malli ka ardhur 3 ditë me vonesë referuar dhe nenit 4 të kontratës së lidhur, pika 4.4, germa a, b dhe c ku citohen hapat që do të ndiqen për ekzekutimin e kontratës dhe konkretisht hapi i parë është ai i lëvrimit të mallit ose magazinimit të tij pastaj ai i kolauditimit dhe marrjes në dorëzim. Pra, ardhja ose jo në afat e mallit të prokuruar, verifikohet nga data që ka hyrë në magazinë dhe jo nga fatura e cila mund të ketë dhe datë më të hershme ose dhe datë më të vonë se data e dorëzimit të mallit.

-Si rezultat, malli ka ardhur 3 ditë me vonesë. Vlera e mallit të ardhur, është 5,148,000 lekë me tvsh. Bazuar tek neni 9, pika 9.1, penalitetet në rast vonesash, kemi: $5,148,000 \text{ lekë} * 4/1000 * 3 \text{ ditë} = 61,776 \text{ lekë}$ është penalteti që i duhej mbajtur operatorit ekonomik █████ sh.a., pasi ka sjellë mallin jashtë afateve të kontratës (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 61,776 lekë dëm ekonomik, nga operatori ekonomik █████ Sh.p.k, penalitet për vonesa në realizimin e punimeve sipas afatit të përcaktuar në kontratë.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit me objekt “Blerje Indikator-Dedektor Gazi H₂S, CO, CH₄” viti 2015, u konstatua se malli i prokuruar duhej të dorëzohej në “Albpetrol” SHA më 18.09.2015. Sipas fletë-hyrjes me nr. 24 të QFMT Patos, malli ka ardhur më 23.09.2015 pra 5 ditë me vonesë. Referuar nenit 9 të kontratës së lidhur, përcaktohet se për çdo ditë vonesë, kontraktuesi është i detyruar ti paguajë Autoritetit Kontraktor, penalitete 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar. Nga kalkulimet rezulton se: $3,805,440 \text{ lekë me tvsh} * 4/1000 * 5 \text{ ditë vonesë} = 76,109 \text{ lekë}$. Si rezultat, **vlera 76,109 lekë** është vlera e penaltetit për vonesa në ekzekutimin e kontratës e cila i duhet mbajtur operatorit ekonomik █████ sh.p.k (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 76,109 lekë dëm ekonomik, nga operatori ekonomik “█████ Sh.p.k, për vonesa në realizimin e punimeve sipas afatit të përcaktuar në kontratë.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit me objekt “Blerje tombino beton-arme Ø1500 mm” viti 2015, sipas kontratës së lidhur midis Albpetrol SHA dhe █████ sh.p.k., u konstatua se malli i prokuruar ka ardhur 1 ditë me vonesë. Vlera e mallit të ardhur, është 1,872,000 lekë me tvsh. Bazuar tek neni 9, pika 9.1, penalitetet në rast vonesash, kemi: $1,872,000 \text{ lekë} * 4/1000 * 1 \text{ ditë} = 7,488 \text{ lekë}$ është penalteti që i duhej mbajtur operatorit ekonomik █████ sh.pk., pasi ka sjellë mallin jashtë afateve të kontratës (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 7,488 lekë dëm ekonomik, nga operatori ekonomik "████" Sh.p.k, penalitet për punime të pa përfunduara në afatin e përcaktuar nënkontratë.

Menjëherë

B.V - Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e marrëveshjeve të hidrokarbureve të lidhura me kompanitë e huaja që operojnë në sektorin e kërkimit dhe nxjerrjes së hidrokarbureve.

-Marrëveshja hidrokarbure për zonën Patos-Marinëz.

21. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2015 ashtu dhe periudhën respektive 2016, kontraktori ka rritur ndjeshëm shpenzimet administrative si dhe ka zvogëluar shpenzimet kapitale referuar planit vjetor. Sipas planit të paraqitur nga kontraktori por të pa miratuar nga Albpetrol për vitin 2016 (janar-qershor), janë parashikuar shpenzime transporti me vlerë 9.4 milionë USD dhe në fakt janë paraqitur shpenzime me vlerë 13.59 milionë USD, me një rritje rreth 30 %. Kjo rritje nuk justifikohet me prodhimin i cili është në nivele të njëjta me programimin. Krahas rritjes së shpenzimeve të pa argumentuara për transport, Kontraktori realizon këtë shërbim me çmime shumë më të larta se tregu. Në minutat e takimit të Komitetit Këshillimor të datës 23.12.2015, cilësohet se Albpetrol ka transportuar naftë brut me të tretë me çmim 17.5 lekë për ton*km ndërsa █████ transporton me 27 lekë për ton*km, për të njëjtat kushte. Duke marrë në konsideratë vlerën e përfshirë në kosto hidrokarbure për transport, e cila për vitin 2015 është me vlerë 12,611 mijë USD dhe për vitin 2016 me vlerë 5,2017 mijë USD, rezulton se █████ ka shpenzuar më shumë referuar çmimit të tregut vlerën 6,273 mijë USD ose 796,043 mijë lekë, vlerë e cila ka rënduar shpenzimet e kostove hidrokarbure dhe ka ndikuar negativisht në Faktorin R (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol në bashkëpunim me AKBN, të marrin masa që gjatë procesit të auditimit të llogarive kosto hidrokarbure të kontraktorit █████, të auditohen me detaje shpenzimet e realizuara për shërbimin e transportit, si nga sasia ashtu dhe nga referenca e çmimeve të aplikuara, duke kërkuar zbritjen e kostove të pa justifikuar, të cilat vetëm nga diferenca e çmimit të aplikuar nga Albpetrol, krahasuar me çmimin e aplikuar nga Kontraktori rezulton një diferencë me vlerë 6,273 mijë USD, ose 796,043 mijë lekë. Krahas auditimit, Albpetrol të marrë masa për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit që realizon kontraktori, me synim minimizimin e kostove të pa argumentuara.

Menjëherë dhe vazhdimisht.

22. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i raporteve të kontraktorit █████, për periudhën janar – mars 2015 në kostot hidrokarbure është përfshirë vlera 21,908 mijë USD, për shpenzime që rrjedhin nga marrëveshja miqësore për ndërprerjen e njëanshme të një kontrate furnizimi me Kompaninë █████.

████ me shkresë nr. 1119, datë 16.07.2015, ka paraqitur pretendimin se shpenzimet si më sipër konsiderohen kosto hidrokarbure, pasi kontraktori ka të drejtë të rikuperojë të gjitha kostot hidrokarbure të përballuara nga ai brenda apo në lidhje me zonën e projektit. Kontraktori pretendon se nuk është pësuar humbje pasi nga prishje e kontratës është akumuluar një fitim më i madh se penaliteti. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure Aneksi B, neni 2, Pika 2.14 "Shpenzimet ligjore".

Pavarësisht përjasjes së Albpetrol SHA dhe AKBN, zbritja nga kostot hidrokarbure e vlerës së mësipërme nuk është realizuar, madje AKBN nuk ka përfunduar hapat e parashikuar në

marrëveshje për këtë qëllim, por e ka shtyrë këtë veprim për periudhën e auditimit. Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me Aneksin B, Neni 2.14 të Marrëveshjes Hidrokarbure duke përfshirë padrejtësisht në kosto hidrokarbure të rikuperueshme vlera 21,909 mijë USD, ose 2,780,252 mijë lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA në bashkëpunim me AKBN, të marrin masat për njoftimin e [REDAKTUAR] në kushtet e devijimit material në përputhje me nenin 8, Pika 8.3 të marrëveshjes hidrokarbure, si dhe pikën 7. 2. iii, c të licencë marrëveshjes dhe të zbresin vlerën 21,909 mijë USD, ose 2,780,252 mijë lekë, nga kostot hidrokarbure të kontraktorit.

Brenda 3-mujorit I^{rë} 2017.

23. Gjetje nga auditimi: Me shkresë nr. 359/1, datë 02.02.2015, Albpetrol ka ngritur shqetësimin për rënien e prodhimit të naftës brut për periudhën tetor-nëntor 2014. Për këtë arsye ka filluar një proces inspektimi të prodhimit pranë vendburimit të Patos-Marinzës.

Albpetrol me shkresë nr. 8933, datë 07.12.2015, drejtuar [REDAKTUAR], për dijeni AKBN dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, ka paraqitur rezultatet e testimit të puseve nga ku ka rezultuar se nga testimi i 147 puseve, 45 kanë rezultuar me diferenca të konsiderueshme të prodhimit faktik, krahasuar me prodhimin e raportuar, me rreth 283 m³ në ditë, në bazë vjetore rreth 103,295 m³, ose rreth 8.5 të prodhimit të përgjithshëm. Ky veprim ka shkaktuar pasoja të rënda financiare për shtetin dhe bazuar në nenin 24, pika 24.2.1, të marrëveshjes hidrokarbure “Mbyllja” si dhe nenin 24, pika 24. 1. a të licencë marrëveshjes “E drejta e AKBN për ta përfunduar marrëveshjen”, ka kryer raportime fallco, pra devijim material. Nga ana e Albpetrol dhe AKBN duhet të bëjë njoftimi përkatës për korrigjim dhe për përfundim të marrëveshjes sipas përcaktimeve të mësipërme në marrëveshje hidrokarbure dhe marrëveshje-licencë.

Bazuar në sa më sipër, referuar periudhës së matjes së prodhimit të 45 puseve, shprehur në përqindje, Kontraktorit [REDAKTUAR] duhet t’i kërkohesh rishikimi i raporteve 3 mujore duke përfshirë në raportet përkatëse edhe sasinë e pa raportuar afërsisht 137,173 m³, me vlerë 31,399 mijë USD, ose 3,984,533 mijë lekë. Sa më sipër, në përputhje me nenin 24, pika 24.2.1 të marrëveshjes hidrokarbure “Mbyllja” si dhe nenin 24, pika 24. 1. a të licencë marrëveshjes “E drejta e AKBN për ta përfunduar marrëveshjen” duhet të bëhesh njoftimi përkatës (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

23.1. Albpetrol SHA në bashkëpunim me AKBN, të marrin masat për njoftimin e Kontraktorit [REDAKTUAR] në kushtet e devijimit material në përputhje me nenin 24, pika 24.2.1 të marrëveshjes hidrokarbure “Mbyllja” si dhe nenin 24, pika 24. 1. a të licencë marrëveshjes “E drejta e AKBN për ta përfunduar marrëveshjen” dhe të llogarisin diferencat e naftës brut për periudhën nga konstatimi, duke kërkuar që të reflektohet në të ardhurat e kontraktorit sasia e naftës rreth 137,173 m³, me vlerë të përafërt 31,399 mijë USD ose 3,984,533 mijë lekë.

Menjëherë

23.2. Drejtoria e marrëveshjeve hidrokarbure, të realizojë inspektim të prodhimit për të gjitha pusët në dispozicion të kontraktorit dhe realizohen monitorime dhe inspektime të vazhdueshme të operacioneve hidrokarbure të kontraktorit, në mënyrë që t’i ndërpritet mundësia e abuzimeve me kostot hidrokarbure, si dhe të marrë masa për njoftimin e organeve kompetente, për rrethana të cilat mund të konsiderohen vepër penale për veprime abuzive të kontraktorit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

24. Gjetje nga auditimi: Bazuar në VKM nr. 947, datë 29.12.2014, detyrimi i krijuar në vite, deri në muajin qershor 2016, në mënyrë progresive dhe me vlerë, bazuar në VKM nr. 947, datë 29.12.2014, [REDAKTUAR] i detyrohet Albpetrol sasinë 76,805.09 ton naftë brut, me vlerë 23,954 mijë USD. Rritja e detyrimit krahasuar me të dhënat e auditimit të mëparshëm (deri mars 2015) ishte në sasinë 39,220 ton me vlerë 15,679 mijë USD. Detyrimi është rritur me vlerë 8,275 mijë USD.

Duke marrë në konsideratë auditimin e realizuar nga Albpetrol dhe mosnjohjen e detyrimeve me vlerë 352,513,463 USD, rezultat i të cilit Faktori R rezulton më i madh se 1, bazuar në nenin 9, pika 2 të Marrëveshjes Hidrokarbure, Kontraktori i detyrohet Albpetrol sasinë 3 % të prodhimit për puset e reja dhe jo 1 % të sasisë. Në këto kushte, referuar periudhës së zbritjes së këtyre kostove, për vitin 2014 dhe në vazhdim Kontraktori duhet të përlllogariste si sasi të Albpetrol masën 3 %.

Sa më sipër si pasojë e kalimit të koeficientit R mbi 1, krahas detyrimit të krijuar në vite ndaj Albpetrol në sasinë 76,805.09 ton (me vlerë 23,954,640.7 USD), Kontraktori i detyrohet Albpetrol edhe sasinë 53,812.3 ton (me vlerë 20,194,234.3 USD). Pra detyrimi që kontraktori ka ndaj Albpetrol duhet të jetë në sasinë 130,617.4 ton me vlerë respektive 44,148 mijë USD (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Albpetrol SHA në bashkëpunim me AKBN, të marrin masat për njoftimin e Kontraktorit [REDAKTUAR] në kushtet e devijimit material, si dhe të merren masat për lëvrimin e sasisë së naftës pjesë e Albpetrol që rrjedh nga marrëveshja në sasinë 130,617.4 ton, me vlerë **44,148 mijë USD, ose 5,514,085 mijë lekë** nga të cilat:*

Sasia 39,220 ton me vlerë 15,679 mijë USD, rekomanduar në auditimin e mëparshëm.

Sasia 43,585 ton me vlerë 8,275 mijë USD, krijuar gjatë periudhës së auditimit.

Sasia 53,812.3 ton me vlerë 20,194 mijë USD, sasi që rrjedh nga rritja e pjesës së Albpetrol për prodhimin e puseve të rinj nga 1 % në 3 % të sasisë së prodhuar.

Brenda 3-mujorit I^{rë} 2017.

-Mbi auditimin e zbatimit të Marrëveshjes Hidrokarbure për zonat Gorisht-Koçul, Cakran-Mollaj, Ballsh-Hekal dhe vendburimin e Delvinës”.

25. Gjetje nga auditimi: Komisioni i përbërë nga z. E.SH, z. I.M, znj. K.M, z. E.D, z. M.B dhe z. N.K, punonjës të Sektorit të Monitorimit dhe Supervizimit, ka njoftuar Drejtorin e Marrëveshjeve Hidrokarbure pranë Albpetrol z. A.D dhe vënë në dijeni Administratorin e Albpetrol z. E.P, mbi monitorimin e prodhimit të puseve, për vendburimin Gorisht-Kocul.

Monitorimi është bërë mbi bazën e letrës nr. 6485 prot., datë 01.09.2016 “Kërkesë për inspektimin e operacioneve hidrokarbure në vendburimin Gorisht-Kocul, në lidhje me prodhimin e naftës”.

Me shkresë nr. 959 prot., datë 16.02.2016, grupi i punës për testimin e prodhimit të puseve, për zonë Gorisht-Koçul. Janë testuar 1 herë 64 puse, 2 herë 54 puse dhe 3 herë 4 puse. Nga 133 puse aktiv, nuk janë testuar 13 puse, është ndërprerë testimi për 26 puse. Në total janë testuar 120 puse, ose 90.9 % të puseve aktivë. Rezultatet e dala nga testimi janë krahasuar me raportimin e prodhimit për muajin tetor 2015, të Kompanisë [REDAKTUAR], nga ku ka rezultuar se: “Nga testimi i puseve zhvilluar në periudhën 21.09.2015 deri me 20.11.2015, dhe në krahasim me deklaratimet e të dhënave të prodhimit mujor Tetor 2015, ka diferenca të konsiderueshme të naftës neto të prodhuar me atë të deklaruar në raportet mujore të prodhimit, të dërguar nga Kompania [REDAKTUAR]”.

Për periudhën dy mujore si më sipër, është konstatuar se prodhimi është në sasinë 122.9 m³, ndërsa raportimi për muajin shtator është 86.1 m³, me diferencë 36.8 m³ ose 29.9 %, si dhe

për muajin tetor raportimi është 79.9 m³, me diferencë 43 m³ ose 34.9 %. Në këto kushte, duke marrë në konsideratë Faktorin R (sipas raporteve të kontraktorit) i cili për vitin 2015 është 0.99 theksojmë se nga diferenca e sasive të raportuara me atë të prodhuar në fakt, Faktori R duhet të ishte më i madh se 1 dhe si rrjedhim duhet të likuidohesh pjesa fitim për Qeverinë Shqiptare. Nga ana e Albpetrol dhe AKBN duhet të kërkohej rillogaritja e Faktorit R dhe mundësi i pjesës fitim si dhe rritjen e sasisë së naftës brut, pjesë e Albpetrol sipas marrëveshjes.

Sa më sipër Albpetrol duhet të kërkonte përfshirjen në prodhimin e raportuar të sasisë rreth 13,505 m³ naftë brut, me vlerë të përafërt [9,800 m³ x 210 (mesatar 2015-2016) USD/ton] 2,058 mijë USD, ose 261,160 mijë lekë.

Kjo shmangie përbën devijim material si dhe deklarimi i të dhënave fallco dhe në përputhje me nenin 24, pika 24.2.1, të marrëveshjes hidrokarbure “Mbyllja” si dhe nenin 24, pika 24.1 të licencë marrëveshjes “E drejta e AKBN për ta përfunduar marrëveshjen”, duhet të bëheshin njoftimet përkatëse kontraktorit (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

25.1. Albpetrol SHA në bashkëpunim me AKBN, të marrin masat për njoftimin e Kontraktorit [REDAKTUAR] në kushtet e devijimit material në përputhje me nenin 24, pika 24.2.1 të marrëveshjes hidrokarbure “Mbyllja” si dhe nenin 24, pika 24. 1. a të licencë marrëveshjes “E drejta e AKBN për ta përfunduar marrëveshjen” dhe të llogarisin diferencat e naftës brut për periudhën nga konstatimi, duke kërkuar që të reflektohet në të ardhurat e kontraktorit sasia e naftës rreth 13,500 m³ naftë brut, me vlerë të përafërt 2,058 mijë USD ose 261,160 mijë lekë, si rezultat i testimit të puseve dhe konstatimit të diferencave në prodhimin e raportuar me atë të rezultuar në fakt.

Menjëherë

25.2. Drejtoria e marrëveshjeve hidrokarbure, të realizojë inspektim të prodhimit për të gjitha pusët në dispozicion të kontraktorit në mënyrë të vazhdueshme, si dhe të marrë masa për njoftimin e organeve kompetente, për rrethana të cilat mund të konsiderohen vepër penale për veprime abuzive të kontraktorit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

26. Gjetje nga auditimi: Bazuar në Pikën 11, të aktmarrëveshjes nr. 1849/2, datë 28.02.2014, nënshkruar ndërmjet Albpetrol dhe Kompanisë [REDAKTUAR], detyrimi i prapambetur i kësaj të fundit në naftë brut, do të shlyhet për një periudhë 6 mujore referuar nënshkrimit të marrëveshjes, me pagesa mujore që do të shpërndahen në mënyrë të njëtrajtshme, për aq kohë sa është e mundur, mesatarisht sa 1/6 pjesë e vlerës së llogaritur.

Nga detyrimi me vlerë 20,832 mijë USD, sipas marrëveshjes së mësipërme është likuiduar vetëm vlera 6,975 mijë USD.

Në marrëveshjen e korrikut 2015, për shuarjen me kompensim të detyrimeve është vendosur kompensimi i rentës minerare me vlerë 10,169,253.51 USD, likuiduar nga Kontraktori me detyrimet që ky kontraktor ka ndaj Albpetrol. Në marrëveshje është përcaktuar se vlera 7,424,724.89 USD, do të shlyhet brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes.

Në këtë marrëveshje nuk është përfshirë detyrimi me vlerë 10,521,755.37 USD, konsideruar dëm ekonomik dhe rekomanduar për t’u përfshirë në marrëveshjen për shuarjen e detyrimeve në auditimin e mëparshëm, pasi nuk garantohet vjelja e detyrimeve të Kompanisë [REDAKTUAR].

Në lidhje sa më sipër, Albpetrol SHA me shkresë nr. 1560/1 prot., datë 21.03.2016, drejtuar MEI, grupit ndërinstitucional të punës dhe AKBN, ka kërkuar që në përputhje me rekomandimet e KLSH, në draftin ekzistues të marrëveshjes Albpetrol do të përfshijë edhe

detyrimet e Kompanisë [REDAKTUAR] (ish [REDAKTUAR]), deri me datë 31.12.2014, edhe detyrimin që i takon për vendburimin e Delvinës, detyrimin për naftën gjendje në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes, detyrimin në formën e kamatëvonesës sipas pikës 19 të aktmarrëveshjes së datës 28.02.2014, si dhe detyrimin naftë brut për efekt të forcës madhore.

Krahas sa më sipër, për periudhën objekt auditimi është shtuar detyrimi si më poshtë:

- Gaz i pa dorëzuar për vendburimin e Delvinës në sasinë 2,358,000 Nm³, me vlerë 1,036 mijë USD ose 131,548 mijë lekë.

-Naftë brut për vendburimin Cakran-Mollaj, në sasinë 9,466.5 ton me vlerë 2,503 mijë USD, ose 317,630 mijë Lekë. Kondensat në sasinë 939.9 ton me vlerë 130 mijë USD, ose 16,578 mijë lekë.

- Si pasojë e kalimit të Faktorit R mbi 1, bazuar në nenin 9, të marrëveshjeve hidrokarbure, Albpetrol duhet të përfitonte nga ndarja e prodhimit në masën 2.5 % të prodhimit, duke filluar nga tetori i vitit 2013. Për zonat Cakran-Mollaj, Ballsh-Hekal dhe Gorisht-Kocul, kontraktori duhet të jepte për Albpetrol SHA 2.5 % të prodhimit për ASP dhe jo 2 % sa ka dhënë, pra nga rishikimi i Faktorit R, Albpetrol duhet të përfitonte më shumë naftë brut në sasinë 17,148 ton, me vlerë 4,836 mijë USD, ose 613,718 mijë lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA në bashkëpunim me AKBN, të marrin masat për njoftimin e Kontraktorit [REDAKTUAR] në kushtet e devijimit material, si dhe krahas detyrimeve të përcaktuara në auditimin e mëparshëm për këto marrëveshje, të merren masat edhe për lëvrimin e sasisë së naftës dhe gazit pjesë e Albpetrol të konstatuar gjatë këtij auditimi me **vlerë 8,505 mijë USD ose 1,079,474 mijë lekë** si më poshtë:

- Gaz i pa dorëzuar për vendburimin e Delvinës në sasinë 2,358,000 Nm³, me vlerë 1,036 mijë USD ose 131,548 mijë lekë.

-Naftë brut për vendburimin Cakran-Mollaj, në sasinë 9,466.5 ton me vlerë 2,503 mijë USD, ose 317,630 mijë Lekë.

Kondensat në sasinë 939.9 ton me vlerë 130 mijë USD, ose 16,578 mijë lekë.

- Naftë brut si pasojë e rishikimit të Faktorit R në masën 2.5 % të prodhimit për sasinë 17,148 ton, me vlerë 4,836 mijë USD, ose 613,718 mijë lekë.

Brenda 3-mujorit I^{rë} 2017.

- Mbi zbatimin e marrëveshjes Hidrokarbure me Kompaninë [REDAKTUAR] ltd.

27. Gjetje nga auditimi: Më datë 31.03.2015 detyrimet e shoqërisë ishin në vlerën 47,962,551 lekë. Për 6-mujorin e parë të vitit 2016 detyrimi i naftës gjithsej është 1,865 ton me vlerë 61,588,912 lekë duke **u shtuar me 13,626,361 lekë.**

Nga ana e Albpetrol duhet të bëheshin përpjekjet e duhura për të kërkuar shlyerjen e detyrimeve që Kontraktori ka, si dhe bërjen e njoftimeve për devijim material, sipas përcaktimeve në marrëveshje (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA në bashkëpunim me AKBN, të marrin masat për njoftimin e Kontraktorit [REDAKTUAR] ltd në kushtet e devijimit material, si dhe krahas detyrimeve të përcaktuara në auditimin e mëparshëm për këto marrëveshje, të merren masat edhe për lëvrimin e sasisë së naftës pjesë e Albpetrol të konstatuar gjatë këtij auditimi në vlerë **13,626 mijë lekë.**

Brenda 3-mujorit I^{rë} 2017.

-Mbi zbatimin e marrëveshjes hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Visokës.

28. Gjetje nga auditimi: Kontraktori për periudhën e zbatimit të marrëveshjes hidrokarbure deri në fund të gjashtë mujorit të parë 2016, i detyrohet Albpetrol naftë brut në sasinë 6,060.2 ton, sasi e cila është rritur ndjeshëm krahasimisht me vitin paraardhës kjo vihet re dhe në vlerën e detyrimit të krijuar për këtë periudhë nga ky kontraktor, e cila referuar çmimit të shitjes sipas vitit përkatës të lindjes së detyrimit, përlllogarit me **vlerë 99,731 mijë lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për Albpetrol SHA Patos.** Kjo vjen si rezultat i zbritjes nga shuma totale e detyrimit prej 196,431,375 lekë, vlerën prej 96,699,691 lekë (vlera e krijuar deri më 31.03.2015) e pasqyruar në auditimin paraardhës 196,431,375 - 96,699,691 = 99,731,684 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 196-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Albpetrol SHA në bashkëpunim me AKBN, të marrin masat për njoftimin e Kontraktorit [REDAKTUAR] në kushtet e devijimit material, si dhe krahas detyrimeve të përcaktuara në auditimin e mëparshëm për këto marrëveshje, të merren masat edhe për lëvrimin e sasisë së naftës pjesë e Albpetrol të konstatuar gjatë këtij auditimi në vlerë **99,731 mijë lekë.***

Brenda 3-mujorit I^ë 2017.

Mbi realizimin e ankandit publik për shitjen e naftës brut.

29. Gjetje nga auditimi: Gjatë muajit mars 2015, është zhvilluar një ankand për shitjen e sasisë 100,000 ton naftë brut, në të cilën është përfshirë sasia 43,268 ton nga detyrimet para vitit 2015, nga e cila 13,656 ton me Kontraktorin [REDAKTUAR] dhe 29,612 ton nga Kontraktori [REDAKTUAR].

Në ankandin tjetër të muajit shkurt 2016, është shitur naftë brut në sasinë 30,000 ton në të cilën përfshihet sasia 16,544 ton detyrim para datës 31.12.2014.

Si pasojë e shitjes në ankande të naftës brut nga sasia e detyrimeve të viteve 2014-2015, janë krijuar të ardhura të munguara për shoqërinë **me vlerë gjithsej 427,105 mijë lekë**, për arsye se, çmimi në bursa për këtë sasi ka qenë në nivele më të larta në momentin e lindjes së detyrimit kontraktual, krahasuar me atë të periudhës përkatëse të shitjes (trajtuar më hollësisht në faqet 193-196 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Albpetrol SHA të marrë masa duke negociuar me kontraktorët [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe kontraktorë e tjerë për kompensimin e sasive të naftës detyrim i viteve të mëparshme në vlerë sipas përcaktimeve VKM nr. 947, datë 29.12.2014, Pika 3, duke shmangur humbjet që vijnë si pasojë e uljes së çmimit të naftës brut në bursë në periudhën aktuale, ku vetëm për periudhë e auditimit ka të ardhura të munguara **me vlerë 427,105 mijë lekë.***

Vazhdimisht

C. EFEKTE NEGATIVE FINANCIARE.

Gjatë auditimit është konstatuar përdorim pa efektivitet të fondeve me vlerë 3,010,832 mijë lekë, të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:

Mbi mbajtjen e evidencave kontabël.

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë analizës së pasqyrës së pozicionit financiar për vitin 2015, nga grupi i auditimit u konstatua se zëri "Fitimi i pashpërndarë paraqitet në shumën - 3,813,605,691 lekë, pra humbje, si rezultat i sistemimeve të mëposhtme:

-3,815,284,319 lekë	Sistemimi i gjendjes së produktit pranë të tretëve për vitet 2011-2014
<u>+1,678,628 lekë</u>	Rimarje amortizimi sipas raportit të zvogëlimit të kapitalit, urdhër nr 577, dt 22.12.2014 te MZHETS, (IAS 08)

-3,813,605,691 lekë

Në vitin 2011 drejtimi i shoqërisë vendosi që detyrimet për produktin naftë të kompanive koncesionare ta konsideronte si gjëndje produkti të gatshëm dhe ta përfshinte në rezultatin e

vitit ushtrimor. Për vitin 2011 vlera ishte 2,228,772,900 lekë, për vitin 2012 vlera ishte 3,707,683 lekë, për vitin 2013 vlera ishte 979,962,123 lekë dhe për vitin 2014 vlera ishte 602,841,613 lekë.

Kjo mënyre paraqitje ka shtrembëruar rezultatin e këtyre viteve me shumat sa më sipër, më tepër duke pasur dhe efekte në llogaritjen e tatimit mbi fitimin si dhe shpërndarjen e dividendit për periudhat përkatëse.

Vlera -3,815,284,319 lekë, humbje e periudhave të mëparshme është korigjim i rezultatit të viteve 2011, 2012, 2013 dhe 2014.

-Dividenti i caktuar nga MZHETS për periudhën 2011-2014 3,746,275,588 lekë

-Dividenti i paguar MZHETS për periudhën 2011-2014 757,308,663 lekë

-Diferenca e mbetur për tu paguar 2,988,966,925 lekë

Dividenti i mundshëm i këtyre viteve duke ruajtur të njëjtën % të aplikuar nga MZHETS në ndarjen e fitimit të vitit është 1,957,548,128 lekë dhe 757,308,663 lekë janë paguar duke mbetur 1,200,239,465 lekë për tu paguar. Diferenca prej 2,988,966,925 lekë që MZHETS ka në detyrimet e Albpetrol SHA do të korigjohet me shumën 1,200,239,465 lekë duke sjellë **një efekt ekonomik negativ në vlerën 1,788,727 mijë lekë për Buxhetin e Shtetit.**

Detyrimet mbi tatim fitimin e shoqërisë janë llogaritur dhe paguar në shumën 1,486,812,704 lekë. Pas korigjimeve shoqëria do të duhej të pagonte vlerën 1,075,142,191 lekë.

Detyrimet mbi tatimin mbi dividendin janë llogaritur dhe paguar në shumën 434,302,813 lekë. Pas korigjimeve shoqëria do të duhej të pagonte vlerën 205,594,594 lekë.

Pagesat e kryer më tepër se sa duhej për detyrime tatimore kanë ulur likuiditetin e shoqërisë duke ndikuar në pagesat e detyrimeve ndaj të tretëve.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, kreu II, Këshilli i administrimit, sistemi me dy nivele, neni 167, “Përbërja, të drejtat e detyrimit e këshillit mbikëqyrës dhe administratorët; 1. Këshilli mbikëqyrës është përgjegjës për të gjitha funksionet e përcaktuara në pikat 1, shkronjat “b” deri në “g” e “i” dhe 2 të nenit 154 të këtij ligji. Neni 154, “Të drejtat dhe detyrimet; 1.Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrimit për t’iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;”

Neni 164 - Përgjegjësia solidare e këshillit të administrimit dhe e administratorëve. Anëtarët e këshillit të administrimit dhe administratorët përgjigjen në mënyrë solidare për vërtetësinë e të gjitha pasqyrave financiare, të publikimeve të detyrueshme dhe informacioneve të tjera kryesore të veprimtarisë së organizimit të shoqërisë, si ato vijuese, por pa u kufizuar në to, informacionin për sistemin e menaxhimit të riskut të shoqërisë, prospektet e veprimtarisë, planet e investimeve, burimet teknike, organizative dhe burimet, strukturat e praktikat e miradministrimit të shoqërisë. Pikat 3 e 5 të nenit 163 të këtij ligji zbatohen edhe për parashikimet e këtij neni (trajtuar më hollësisht në faqet 57-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria Ekonomike, drejtimi i Albpetrol SHA., këshilli mbikëqyrës, ekspertët kontabël që kryejnë certifikimin e pasqyrave financiare të shoqërisë, të marrin masa për përgatitjen me përgjegjësi dhe certifikimin e pasqyrave financiare sipas standardet e kontabilitetit që zbatohen, duke shmangur fenomenet e deformimit të rezultatit financiar si dhe pasojat e ndryshimit të politikës kontabël (apo gabimit në trajtim).

Të merren masat për të korigjimin e detyrimeve financiare ndaj MZHETTS, si dhe të likuidohet menjëherë detyrimi i mbetur. Të kryhen saktësimet me Drejtorinë e Tatim Taksave për vlerat e paguara më tepër, për detyrimet mbi tatim fitimin e shoqërisë dhe për tatimin mbi dividendin.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Mbi auditimin e gjendjes së debitorëve dhe kreditorëve, si dhe zbatimin e ligjshmërisë për inventarizimin e pasurisë.

2. Gjetje nga auditimi: Për sa i përket gjendjes së debitorëve dhe kreditorëve arrijmë në konkluzionin e një punë të dobët të shoqërisë Albpetrol SHA në arkëtimin e detyrimeve që të tretët kanë ndaj tyre vlerë e cila në total është 17,643,210,596 lekë si dhe nga mos arkëtimi i detyrimeve të lindura rishtas, të cilat vetëm gjatë këtij viti kapin vlerën 752,677,184 lekë, ndërsa gjendja kreditore me 31.12.2015 paraqitet në vlerën prej 8,389,953,006 lekë vlerë e cila vetëm për këtë vit është rritur me vlerë **564,402,202 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 80-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të analizojnë gjendjen debitorë dhe kreditorë më datë 31.12.2015, si dhe të marrë masat e nevojshme për reduktimin e tyre me vlerë **564,402, mijë lekë**, përmes hartimit dhe miratimit të një plani afatgjatë.*

Vazhdimisht

3. Gjetje nga auditimi: Me akt-rakordimin e mbajtur midis dy shoqërive ■ dhe Albpetrol SHA është shlyer fatura për kamat vonesa të prapambetura në shumën prej **644,031 mijë lekë**, si rezultat i mos shlyerjes në kohë të faturave të energjisë elektrike me efekt financiar negative për shoqërinë Albpetrol SHA (trajtuar më hollësisht në faqet 80-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i Shoqërisë si dhe drejtoritë përkatëse të marrin masa që në të ardhmen likuidimet e detyrimeve ndaj furnitorëve të bëhen sipas përcaktimeve në kontratën përkatëse për të shmangur penalitetet e mundshme, të cilat për periudhë e auditimit janë me vlerë **644,031 mijë lekë**.*

Vazhdimisht

4. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të listë-pagesave të administratës së Albpetrol SHA, rezulton se në muajin gusht 2015, Albpetrol SHA ka kryer pagesa për shpërblimin e Grupit të punës të ngritur me Urdhër të Ministrit nr. 540, datë 20.07.2010, “Për përgatitjen e rregullores për shfrytëzimin dhe ruajtjen e mbi dhe nëntokës në blloqet e kërkimit dhe në vendburimet e naftës dhe/ose të gazit, gjatë kërkimit dhe në vendburimet e naftës dhe/ose gazit, gjatë zhvillimit të operacioneve hidrokarbure” të ndryshuar, 25 persona, nga të cilët 18 punonjës të Albpetrol SHA dhe 7 persona të tjerë i përkasin MEI-t, AKBN etj., me vlerë neto 2,167,500 lekë, duke përfituar shpërblim midis të tjerëve, Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës K.B, Administratori i Albpetrol SHA, Drejtori ekzekutiv i AKBN, Drejtori i Hidrokarbureve në Ministri etj. ***Një urdhër i tillë i ministrit të MEI-t është në tejkalim të kompetencave të tij, duke rënduar koston e shpenzimeve të Albpetrol SHA për 2,167,500 lekë***, duke kryer shpenzime pa asnjë lloj efektiviteti, për më tepër që ky dokument nuk është në kuadrin e veprimtarisë së Albpetrol SHA, si dhe nga shkresa e mësipërme rezulton se është një Rregullore e vitit 2010 (trajtuar më hollësisht në faqet 80-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Albpetrol SHA të analizojë dhe të marrë masa për dhënien e shpërblimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim uljen e shpenzimeve dhe kostove të shoqërisë, shpenzime të cilat për periudhë e auditimit janë në vlerë 2,167 mijë lekë.

Vazhdimisht

Mbi auditimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtim RVM 5000 m3/11 të ri, me sistem ngrohje e termoizolim dhe punime ndërtimore, mjedisore e teknologjike, në stacionin e naftës Zharrëz të QASHNG, Patos”, viti 2015.

5. Gjetje nga auditimi: AK në kundërshtim të plotë me dispozitat e prokurimit publik, ka përcaktuar një fond limit të paargumentuar dhe të pa dokumentuar. AK ka përlllogaritur një fond limit të tejfryrë, i cili i ka shkaktuar një efekt negativ financiar ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA, me vlerë **11,496,240 lekë. Kjo vlerë del si rezultat e verifikimit të analizës së çmimeve të realizuara nga AK, krahasuar me ato të miratuara sipas zërave të preventivit.**

AK në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, ka nxjerrë urdhrin e prokurimit, në të cilin dispozitat ligjore të përdorura, janë të gabuara.

Në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, AK nuk ka argumentuar dhe dokumentuar vendosjen e kriterëve për kualifikim, duke mos mbajtur procesverbalin mbi vendosjen e kriterëve për kualifikim, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës.

AK në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, nuk ka nënshkruar dokumentet e tenderit në çdo faqe.

Kriteret për kualifikim, të hartuara nga AK, janë diskriminuese dhe në kundërshtim me ligjin.

AK nuk ka respektuar afatet e ankimit, ashtu sikurse parashikohet në ligj.

AK, në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP, ka kualifikuar shoqëri, të cilat nuk plotësojnë kriteret për kualifikim.

AK në kundërshtim të plotë me dispozitat e prokurimit publik, nuk duhej të kishte nënshkruar kontratën me shoqërinë e vetme të kualifikuar në tender, si dhe nuk duhej të kishte bërë miratimin e raportit përmbledhës (trajtuar më hollësisht në faqet 89-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA të shqyrtojë vlerën 11,496,440 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit “Ndërtim RVM 5000 m3/11 të ri, me sistem ngrohje e termoizolim dhe punime ndërtimore, mjedisore e teknologjike, në stacionin e naftës Zharrëz të QASHNG, Patos”, viti 2016”, u konstatua se nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, pasi janë rritur në mënyrë të pa argumentuar dhe të pa bazuar ligjërisht shpenzimet në fazën e përlllogaritjes së fondit limit, si pasojë e së cilës është rënduar padrejtësisht kostoja e investimit me vlerë 11,496,440 lekë.

Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për shoqërinë Albpetrol SHA dhe buxhetin e shtetit përbën efekt negativ financiar.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

I. Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, i kërkojmë Këshillit Mbikëqyrës të Albpetrol SHA, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

“Largim nga detyra”, për:

z. E.P., me detyrë Administrator i Albpetrol SHA, sepse:

-Me urdhrin nr. 380/1 prot, datë 04.02.2014, për pagesën e biletave të transportit të punonjësve në qendrat e punës, në pagën mujore të përfituesve, për vitin ushtrimor 2015, i ka shkaktuar shoqërisë një dëm ekonomik në vlerën **26,122,520 lekë**.

-Në detyrat e përcaktuara nga ligji nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, është marrja e masave për përgatitjen e besueshme dhe me përgjegjësi të pasqyrave financiare sipas standardet e kontabilitetit që zbaton shoqëria. Ky detyrim nuk është zbatuar nga z. E.P duke sjellë pasoja dhe efekte ekonomike negative për shoqërinë si dhe për aksionerin, si dhe duke mos dhënë një paraqitje objektive të gjendjes financiare dhe performancës së institucionit.

-Gjatë procesit të negociimit të kontratës me ekspertët për vlerësimin e asetëve të shoqërisë nuk ka vepruar me ekonomicitet, efektivitet dhe efizienzë në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar e kontrollin”.

Me veprimet apo mosveprimet e tij, ka nxjerrë urdhra prokurimi, duke përzgjedhur procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, duke ju shmangur në këtë mënyrë procedurave të zhvilluara me mjete elektronike. Ka bërë miratimet e fondeve limite respektive, të cilat nuk janë të dokumentuara dhe të argumentuara në përputhje me ligjin, duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë, ka miratuar raporte përmbledhëse në kundërshtim me ligjin, në disa raste nuk ka nxjerrë urdhër të veçantë për ngritjen e KVO, sikurse parashikohet në ligj. Gjithashtu, ka bërë miratimet e raporteve përmbledhëse, ndërkohe që të gjitha procedurat e prokurimit, objekt auditimi duhej të anuloheshin dhe të rishpallehin në faqen www.app.gov.al, në një rast ka bërë miratimin e raportit përmbledhës, pavarësisht se ka qenë në dijeni të faktit që oferta ka gabime aritmetike më shumë se 2% i lejuar me ligj. Në një rast ka bërë miratimin e raportit përmbledhës, pavarësisht se ka qenë në dijeni të faktit që shoqëria fituese nuk plotëson kriteret për kualifikim, shprehur kjo nga një anëtar i KVO. Ka nënshkruar duke kthyer në akt urdhra prokurimi, duke zhvilluar procedura prokurimi të cilat nuk zhvillohen me mjete elektronike, të paargumentuara, të paarsyetuara dhe në kundërshtim me ligjin, nuk janë dhënë të detajuara arsytet e përdorimit të kësaj procedure, e cila përdoret vetëm në rrethana të caktuara, të justifikuara dhe të veçanta, duke ju shmangur në këtë mënyrë LPP. Në dy raste ka nxjerrë urdhrin e prokurimit, por ndërkohë është vazhduar me procedurën, me nënshkrimin e kontratave respektive, pa u bërë miratimi i raportit përmbledhës, etj, *shkelje të cilat janë të pasqyruara hollësisht dhe të detajuara në raportin përfundimtar të auditimit*.

- Nuk ka marrë masat e duhura të parashikuara në Artikullin 24.2, të Marrëveshjeve Hidrokarbure, për të bërë paralajmërimet për thyerje të marrëveshjeve kryesisht në akumulimin e detyrimeve nga Kontraktorët. Si pasojë e shitjes së naftës brut nga detyrimet e mëparshme të kontraktorëve, janë krijuar të ardhura të munguara për shoqërinë në vlerë 427,105 mijë lekë.

- Nuk ka marrë masat e duhura për njoftimin e kontraktorëve për thyerje marrëveshje, si dhe njoftimin e organeve kompetente për diferencën e prodhimit të puseve të raportuar nga kontraktorët, krahasuar me prodhimin në fakt rezultuar nga testimi i puseve.

-Nuk ka marrë masat e duhura për zbritjen e kostove hidrokarbure të pa njohura, për zërin shpenzime ligjore, sipas marrëveshjes hidrokarbure për zonën Patos-Marinëz. Po ashtu nuk janë marrë masat për zbritjen e kostove hidrokarbure të pa justifikuara nga kontraktorët, rezultuar nga auditimi i llogarive të kontraktorëve për aktivitetin e marrëveshjeve për periudhën tetor-dhjetor 2012 dhe janar-tetor 2013. Mosveprimet e administratorit kanë favorizuar kompanitë që të mbajnë Faktorin R më të vogël se 1 dhe rrjedhimisht mos dhënien e fitimit për Qeverinë Shqiptare.

- Nuk ka njoftuar kontraktorin sipas marrëveshjes për zonat Gorisht-Kocul, Ballsh-Hekal, Cakran-Mollaj dhe Delvinë, për devijimin e marrëveshjes nga ndryshimi i njëanshëm i raportit të shpenzimeve operative, krahasuar me shpenzimet kapitale, nga 50 % me 50 % në 70 % me 30 %.

- Administratori i shoqërisë nuk ka ushtruar të drejtat që përcaktojnë marrëveshjet hidrokarbure për ngritjen e problematikave në komitetin këshillimor.
- Administratori i shoqërisë nuk ka marrë masat e duhura për ngritjen e shqetësimeve që vijnë nga realizimi i prokurimeve në mënyrë jo transparente nga ana e kontraktorëve në marrëveshjet hidrokarbure. Nuk janë marrë masat e duhura për minimizimin e abuzimeve të kontraktorëve në përfshirjen e vlerave të larta në kostot hidrokarbure.
- Nuk janë njoftuar kontraktorët për devijim material, nga hipotekimi i aseteve të përfshira si kolateral në banka për marrje kredie, megjithëse ka patur përpjekje për këtë qëllim.

II. Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe kontratën Individuale të punës e unifikuar neni 14, miratuar me Vendim nr. 31, datë 13.06.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Albpetrol SHA, kërkojmë nga Administratori i Shoqërisë të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

a. “Largim nga puna” për:

1. z. A.D, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure, sepse:

- Nga ana e Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure nuk janë marrë masat e duhura të parashikuara në Artikullin 24.2, të Marrëveshjeve Hidrokarbure, për të bërë paralajmërimet për thyerje të marrëveshjeve kryesisht në akumulimin e detyrimeve nga Kontraktorët. Si pasojë e shitjes së naftës brut nga detyrimet e mëparshme të kontraktorëve, janë krijuar të ardhura të munguara për shoqërinë në vlerë 427,105 mijë lekë.
- Nuk ka marrë masat e duhura për njoftimin e kontraktorëve për thyerje marrëveshje, si dhe njoftimin e organeve kompetente për diferencën e prodhimit të puseve të raportuar nga kontraktorët, krahasuar me prodhimin në fakt rezultuar nga testimi i puseve.
- Nuk ka marrë masat e duhura për zbritjen e kostove hidrokarbure të pa njohura, për zërin shpenzime ligjore, sipas marrëveshjes hidrokarbure në zonën Patos-Marinëz. Po ashtu nuk janë marrë masat për zbritjen e kostove hidrokarbure të pa justifikuar nga kontraktorët, rezultuar nga auditimi i llogarive të kontraktorëve për aktivitetin e marrëveshjeve për periudhën tetor-dhjetor 2012 dhe janar-tetor 2013.
- Nuk ka njoftuar kontraktorin sipas marrëveshjes për zonat Gorisht-Koçul, Ballsh-Hekal, Cakran-Mollaj dhe Delvinë, për devijimin e marrëveshjes nga ndryshimi i njëanshëm i raportit të shpenzimeve operative, krahasuar me shpenzimet kapitale, nga 50 % me 50 % në 70 % me 30 %.
- Nuk janë ushtruar të drejtat që përcaktojnë marrëveshjet hidrokarbure për ngritjen e problematikave në komitetin këshillimor.
- Drejtoria Hidrokarbure nuk ka marrë masat e duhura për monitorimin e prokurimeve nga kontraktorët, për minimizimin e abuzimeve të kontraktorëve në përfshirjen e vlerave të larta në kostot hidrokarbure.
- Nuk janë njoftuar kontraktorët për devijim material, nga hipotekimi i aseteve të përfshira si kolateral në banka për marrje kredie, megjithëse ka patur përpjekje për këtë qëllim.

2. z. N.N, në cilësinë e hartuesit të fondit limit për prokurimet sepse:

- Ka kryer shkelje të përsëritura të legjislacionit të prokurimit publik, si personi kryesor, i cili ka bërë argumentimet dhe miratimet përpara dërgimit të tyre titullarit të institucionit, të fondeve limite të procedurave respektive të audituara, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë, të cilat nuk janë të dokumentuara dhe të argumentuara në përputhje me ligjin.
- Në kundërshtim me ligjin, ka vlerësuar në mënyrë të padrejtë ofertat e shoqërive pjesëmarrëse, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë, etj, *shkelje të cilat janë të pasqyruara hollësisht dhe të detajuara në raportin përfundimtar të auditimit.*

3. z. E.M, në cilësinë Drejtorit të QASHNG Patos, për arsye se:

-Për shkelje të legjislacionit të prokurimit publik, në cilësinë e personave përgjegjës për hartimin e fondeve limite të procedurave respektive të audituara, *shkelje të cilat janë të pasqyruara hollësisht dhe të detajuara në raportin përfundimtar të auditimit.*

-Për miratimin e zbritjes së firove të llogaritura tej normave ligjore për periudhën 01.07.2015-30.09.2016, në sasinë **121.66 ton dhe vlerën 2,676,455 lekë** (e llogaritur me çmimin e brendshëm të përdorur nga QASHNG Patos 22,000 lekë/ton), e cila **përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit dhe shoqërinë Albpetrol SHA**. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, i ndryshuar.

-Për mos-zbatimin e Vendimit të Administratorit të Albpetrol SHA nr. 497, datë 14.10.2015, me anë të të cilit është vendosur zbatimin e rekomandimit të KLSH, për zhdëmtimin e dëmit ekonomik në vlerën 2,253,596 lekë, vlerë e cila **përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit dhe shoqërinë Albpetrol SHA**.

- Janë mbajtur pasqyra, hartimi dhe përmbajtja e të cilave krijon dyshime për ndërhyrje.

b. “Nga “Paralajmërim për pushim nga puna” deri në “Largim nga puna” për:

1. z. F.G, në cilësinë e anëtarit të Komitetit Këshillimor për marrëveshjen hidrokarbure për zonë Patos-Marinëz, sepse:

- Nuk janë ushtruar të drejtat që përcaktojnë marrëveshjet hidrokarbure për ngritjen e problematikave në komitetin këshillimor.

- Nuk ka marrë masat e duhura për ngritjen e problemit të diferencës së prodhimit të puseve në mbledhjet e komitetit këshillimor.

- Nuk ka ngritur shqetësimin mbi detyrimet e kontraktorëve ndaj Albpetrol, për pjesën e naftës brut dhe gazit, sipas marrëveshjeve hidrokarbure.

- Për shkelje të legjislacionit të prokurimit publik, në cilësinë e personit përgjegjës për vlerësimin e ofertave në një rast, etj.

2. z. P.S, në cilësinë anëtarit të Komitetit Këshillimor për marrëveshjen hidrokarbure për zonat Ballsh-Hekal, Gorisht-Koçul, Cakran-Mollaj dhe vendburimi i Delvinës, sepse:

- Nuk ka ngritur në mbledhjen e komitetit këshillimor devijimin e marrëveshjes nga ndryshimi i njëanshëm i raportit të shpenzimeve operative, krahasuar me shpenzimet kapitale, nga 50 % me 50 % në 70 % me 30 %, në mbledhjet përkatëse të komitetit këshillimor.

- Nuk ka ngritur shqetësimin mbi detyrimet e kontraktorëve ndaj Albpetrol, për pjesën e naftës brut dhe gazit, sipas marrëveshjeve hidrokarbure.

- Nuk ka marrë masat e duhura për ngritjen e problemit të diferencës së prodhimit të puseve në mbledhjet e komitetit këshillimor.

-Për shkelje të legjislacionit të prokurimit publik, në cilësinë e personit përgjegjës për hartimin e fondeve limite të procedurave respektive të audituara.

3. z. G.D me detyrë Drejtor Ekzekutiv, sepse:

Gjatë procesit të negociimit të kontratës me ekspertët për vlerësimin e aseteve të shoqërisë nuk ka vepruar me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar e kontrollin”.

-Nuk ka respektuar asnjë afat ligjorë në lidhje me përfundimin e procesit të identifikimit dhe regjistrimit të pasurive, si atë të përcaktuar në Urdhrin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe privatizimit nr. 418 datë 07.09.2001 me afat përfundimi deri më 31.12.2001 si dhe të shkresës së Ministrit nr. 1306 datë 16.02.2015 drejtuar Albpetrol SHA Patos kërkohet informacion për: *Përfundimin e procesit të regjistrimit të pasurisë së shoqërisë*

-Për shkelje të legjislacionit të prokurimit publik, në cilësinë e personit përgjegjës për vlerësimin e ofertave në një rast (pasi në rastin tjetër ka vlerësuar sipas LPP), etj.

4. z. E.A, me detyrë Drejtor i QPN Ballsh, sepse:

Gjatë zbatimit të kontratës me objekt “Shërbimi i remonteve kapitale të puseve” viti 2015, ka nxjerr urdhra për fillimin e riparimit të defekteve të puseve dhe zëvendësimin e pajisjeve elektro-mekanike të dëmtuara dhe jo për zbatimin e kushteve të kontratës së lidhur. Gjithashtu, nga po i njëjti Drejtor, janë nxjerr urdhra për përsëritjen e punimeve tek i njëjti pus edhe pse më parë është vënë në punë ose jo, pa bërë më parë një analizë tekniko-ekonomike ose pa marrë mendimin e Këshillit Teknik të “Albpetrol” SHA, duke shmangur të gjitha hallkat e miratimit ose të kryerjes së punimeve. Me urdhrat e nxjerr, Drejtori i QPN Ballsh, ka orientuar zbatimin e kontratës për kryerjen e shërbimit/riparimit dhe jo për vënien në punë të pusit dhe marrjen e prodhimit të naftës.

5. Z. Dh.Gj,

6. Z. H.D,

7. Z. P.B,

8. Znj. R.G,

9. Z. V.Xh,

10. Z. G.N,

11. Z. A.S, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të hartimit të fondit limit për realizimin e prokurimeve, sepse:

- Kanë kryer shkelje të përsëritura të legjislacionit të prokurimit publik, në cilësinë e personit përgjegjës për hartimin dhe miratimin e fondeve limite të procedurave respektive të audituara, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik, etj, *shkelje të cilat janë të pasqyruara hollësishtëm dhe të detajuara në raportin përfundimtar të auditimit.*

12. z. A.H, në cilësinë e Drejtorit Juridik, sepse:

- Për mos kryerjen e procedurave ligjore për lirimin e pronave të identifikuar si të zëna pa marrë në konsideratë ato të cilat nga ana e shoqërisë nuk janë identifikuar si të tilla akoma.

- Ka kryer shkelje të përsëritura të legjislacionit të prokurimit publik, në cilësinë e personit përgjegjës për hartimin dhe miratimin e fondeve limite të procedurave respektive të audituara, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik, etj, *shkelje të cilat janë të pasqyruara hollësishtëm dhe të detajuara në raportin përfundimtar të auditimit.*

c. “Nga “Vërejtje” deri “Paralajmërim për largim nga puna”për:

1. znj V.J me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Ruajtjes dhe Administrimit të pronës, sepse:

-Gjatë procesit të negocimit të kontratës me ekspertët për vlerësimin e aseteve të shoqërisë nuk ka vepruar me ekonomikitet, efektivitet dhe efizienzë në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar e kontrollin”.

-Nuk ka zbatuar V.K.M Nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar me vendimin e KM nr nr. 735, datë 5.11.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore".

Për mos identifikimin dhe propozim për nxjerrjen nga kontabiliteti i shoqërisë të pasurive që kanë kaluar në pronësi të EKB dhe një pjesë bashkive respektive sipas ndarjes së re territoriale duke sjellë një shtrembërim të pasqyrës së aseteve të kësaj shoqërie si dhe deformim të situatës financiarë të Albpetrol SHA.

-Për mos ndjekje të këtij detyrimi në kundërshtim me detyrat funksionale të drejtorisë të parashikuara në Rregulloren e Brendshme të shoqërisë të miratuar me nr. 1357, datë 22.04.2013 dhe mbi të gjitha me pikën 7 të saj ku citohet: “Të ngre probleme për

administratorin dhe të sugjerojë zgjidhje”, për mos nisjen e procedurave për lirimin e pronave nga një nga format që parashikon ligji si dhe nga Administratori i shoqërisë E.P.

2. z. D.F

3. z. A.H

4. znj. Zh.N, në cilësinë e anëtarëve të grupit të punës të ngritur për përfundimin e procesit të identifikimit dhe përfundimit të regjistrimit të asetëve, sepse: Nuk kanë respektuar asnjë afat ligjorë në lidhje me përfundimin e procesit të identifikimit dhe regjistrimit të pasurive, si atë të përcaktuar në Urdhrin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe privatizimit nr. 418 datë 07.09.2001 me afat përfundimi deri më 31.12.2001 si dhe të shkresës së Ministrit nr. 1306 datë 16.02.2015 drejtuar Albpetrol SHA Patos kërkohet informacion për: *Përfundimin e procesit të regjistrimit të pasurisë së shoqërisë brenda muajit shkurt 2015.*

5. A.H,

6. Sh.Xh

7. R.H në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve, sepse: -Gjatë zbatimit të kontratës me objekt “Shërbimi i remonteve kapitale të puseve” viti 2015, kanë marrë në dorëzim, punime të cilat janë në kundërshtim me kushtet e zbatimit të kontratës duke favorizuar sipërmarrësin për të përfituar pagesa të cilat janë për shërbime/riparime/zëvendësime/përsëritje, që nuk kanë sjellë aspak prodhimin e naftës nga këto puse ashtu siç kërkohet tek termat e referencës së kontratës ku citohet tek pika 9, se: *“Likuidimi i kontraktorit do të bëhet vetëm në bazë të situacionit faktik të mbajtur për çdo pus të secilës Qendër sipas tarifës orare të konfirmuar nga supervizori”* dhe tek pika 10, citohet se: *“Likuidimi i kontraktorit nuk do të bëhet në rastet kur pusi nuk vihet në shfrytëzim për arsye të cilësisë së dobët të punimeve të kryera nga ai dhe të konfirmuara nga supervizori (mbikqyrësi i punimeve) dhe Qendra përkatëse”*. Gjithashtu, tek aktet teknike të mbajtura nga personat e mësipërm, nuk citohet aspak se kush ka qenë arsyeja e mosvënies në punë të pusit përkatës duke mos specifikuar përgjegjësinë dhe duke shmangur kështu likuidimet e padrejta.

8. znj. V.S,

9. z. A.B

10. z. F.B

11. z. F.S

12. z. O.K

13. z. Th.M

14. z. N.C

15. znj. O.F

16. z. R.B

17. znj. K.M

18. z. M.R

19. z. L.Ç

20 znj. A.B

21. z. Ll.M

22 znj. K.L

23. z. B.S

-Për shkelje të legjislacionit të prokurimit publik, në cilësinë e personave përgjegjës për hartimin e fondeve limite të procedurave respektive të audituara, *shkelje të cilat janë të pasqyruara hollësishtëm dhe të detajuara në raportin përfundimtar të auditimit.*

Shënim: Masat disiplinore për znj. E.P, në cilësinë e ish Drejtore e Drejtorisë së Financës, konsiderohet e ezauruar, sepse ka shkëputur marrëdhëniet e punës me institucionin.

E. TË TJERA

Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Vendimi përkatës i Kryetarit do t'i përcillet për dijeni Kuvendit, Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese Tregtinë dhe Mjedisin, Kryeministrit, Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Ministrit të Financave.

Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Vendimi përkatës do t'i përcillen për vlerësim Prokurorisë së Përgjithshme.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R

Shënim 1: Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Vendimi nr. 179, datë 31.12.2016 i Kryetarit të KLSH, i është përcjellë:

- Albpetrol SHA dhe Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë, me shkresë nr. 814/15, datë 31.12.2016.
- Ministrisë së Ekonomisë dhe Industrisë, me shkresë nr. 814/16, datë 31.12.2016.
- Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, me shkresë nr. 814/17, datë 03.01.2017.
- Komisionit Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, me shkresë nr. 814/18, datë 03.01.2017.
- Ministrisë së Financave, me shkresë nr. 814/19, datë 03.01.2017.
- Kryeministrit, me shkresë nr. 814/20, datë 03.01.2017.
- Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresë nr. 814/21, datë 10.01.2017.

Shënim 2: Nga Albpetrol SHA, nuk është kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor, në zbatim të nenit 15/j, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit ” rreth hartimit të programeve për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresë nr. 814/15, datë 31.12.2016.